



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 251/13 Prot.

Tiranë, më 30.04.2021

V E N D I M

Nr. 56, Datë 30.04.2021

MBI

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 3 SUBJEKTE PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA PËR PERIUDHËN 01.01.2020 DERI 30.06.2020, RESPEKTIVISHT: UJËSJELLËS KANALIZIME SHA KAVAJË, PORTI DETAR SHA VLORË DHE REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 2 SHA TIRANË.

Në auditimin e ushtruar në 3 subjekte për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.01.2020 deri 30.06.2020, respektivisht: *Ujësjiellës Kanalizime SHA Kavajë, Porti Detar SHA Vlorë dhe Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 SHA Tiranë*, u konstatua se në përfundim të procesit të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura nga subjektet në fazën e Projektraportit të Auditimit, gjetjeve të konstatuara të cilat janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimi, situata e zbatimit të rekomandimeve në 3 subjektet e audituara, paraqitet si më poshtë:

Janë rekomanduar gjithsej **217** masa, të cilat janë pranuar nga subjektet **209** masa ose 96 % dhe nuk janë pranuar **8** masa, ose 4 %. Nga të pranuarat janë zbatuar (plotësisht dhe pjesërisht) dhe janë në proces zbatimi, gjithsej **163** masa ose 78 % dhe nuk kanë filluar akoma procesin e zbatimit **46** masa ose 22 %.

Nga 3 subjektet e audituara, kanë kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve, gjithsej 2 subjekte ose 66.6 % dhe në afatin e 6 muajve, 1 subjekt ose 33.3 %.

Sipas llojit të masave dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve, situata paraqitet si më poshtë:

- **132** masa organizative, nga të cilat pranuar janë nga subjektet 126 masa, ose 95.5 %. Nga të pranuarat janë zbatuar 71 masa, janë zbatuar pjesërisht 14 masa, janë në proces zbatimi 14 masa dhe nuk kanë filluar akoma procesin e zbatimit 27 masa (*sipas pasqyrës Aneks 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*);

- **10 masa shpërblim dëmi** me vlerë 106,391 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar nga subjektet 10 vlera 106,391 mijë lekë, ose 100 %. Nga këto janë zbatuar 2 masa, ose 20 % me vlerë 133 mijë lekë, ose 0.1 %, janë zbatuar pjesërisht 3 masa, ose 30 %, me vlerë 4,880 mijë lekë, ose 4.6 %, janë në proces zbatimi 2 masë, ose 20 %, me vlerë 116 mijë lekë, ose 0.1 % dhe nuk kanë filluar akoma procesin e zbatimit 3 masa, ose 30 % me vlerë 101,261 mijë lekë, ose 95.2 % *(sipas pasqyrës Aneks 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **12 masa mos efektivitet të fondeve publike (3-E)** me vlerë 98,864 mijë lekë, nga të cilat pranuar nga subjektet 12 masa me vlerë 98,864 mijë lekë, ose 100 %. Nga këto janë zbatuar 7 masa, ose 58.3 % me vlerë 81,916 mijë lekë, ose 82.8 %, është zbatuar pjesërisht 1 masë, ose 8.3 % me vlerë 813 mijë lekë, ose 0.8 % dhe nuk kanë filluar akoma procesin e zbatimit 4 masa, ose 33.3 % me vlerë 16,135 mijë lekë, ose 16.3 % *(sipas pasqyrës Aneks 4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **1 masë e ardhur e munguar** me vlerë 900 mijë lekë, e cila është pranuar dhe zbatuar nga subjekti. *(sipas pasqyrës Aneks 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **1 masë për detyrime ndaj të tretëve** me vlerë 96,096 mijë lekë, e cila është pranuar nga subjekti por nuk është zbatuar *(sipas pasqyrës Aneks 7 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **6 masa në drejtim të shmangies së paligjshmërisë** me vlerë 682,461 mijë lekë, nga të cilat pranuar nga subjektet 5 masa, ose 83.8 % me vlerë 650,453 mijë lekë, ose 95.3 %. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, ose 60 % me vlerë 13,191 mijë lekë, ose 2 %, është zbatuar pjesërisht 1 masë, ose 20 % me vlerë 3,956 mijë lekë, ose 1 % dhe është në proces zbatimi 1 masë, ose 20 % me vlerë 633,306 lekë, ose 97 %. *(sipas pasqyrës Aneks 8 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **1 masë për shmangien e pagesave të kryera në mënyrë të parregullt** me vlerë 37,166 mijë lekë, e cila është pranuar nga subjekti por nuk është zbatuar *(sipas pasqyrës Aneks 9 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **49 masa disiplinore**, nga të cilat pranuar nga subjektet 48 masa, ose 98 %. Nga të pranuarat, janë zbatuar 38 masa, ose 79 % dhe nuk janë zbatuar 10 masa, ose 21 % *(sipas pasqyrës Aneks 10 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;
- **5 masa administrative**, nga të cilat pranuar nga subjektet 5 masa, ose 100 %. Nga këto janë zbatuar 3 masa, ose 60 % dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa, ose 40 % *(sipas pasqyrës Aneks 11 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)*;

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për 6-mujorin e parë të vitit 2020”, të ushtruar në 3 subjekte, respektivisht: *Ujësjetllës Kanalizime SHA Kavajë, Porti Detar SHA Vlorë dhe Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 SHA Tiranë*, sipas programit të auditimit nr. 251/1 prot., datë 11.02.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të **rikërkoj** zbatimin e tyre, për sa vijon:

I. UJËSJELLËS KANALIZIME SHA KAVAJË

Konkluzioni i auditimit: Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe manualit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Ujësjetllës Kanalizime SHA Kavajë për periudhën 01.01.2018 deri me 31.12.2019 dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, rezultoi se:

Niveli (në numër) i pranueshmërisë së rekomandimeve është në masën 100 % në numër. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar (në numër), plotësisht, pjesërisht dhe proces zbatimi është 52.4 %.

E shprehur në vlerë, nga vlera e rekomanduar prej 213,493 mijë lekë janë pranuar në masën 100 % nga subjekti. Pavarësisht pranueshmërisë së subjektit, nuk është zbatuar asnjë prej masave të kategorisë shpërblim dëmi, për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike dhe detyrimeve ndaj të tretëve, ose vlera 213,493 mijë lekë.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 52.4 % (përfshirë këtu ato të zbatuara, zbatuar pjesërisht dhe në proces) si numër total rekomandimesh por 0 % në vlerë, çka tregon se nga Ujësjetllës Kanalizime SHA Kavajë nuk është vlerësuar drejtë procesi i zbatimit të rekomandimeve dhe duhet të përqendrohet kryesisht në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara dhe ndjekjen e tyre përmes proceseve gjyqësore, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërkimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht nga auditimi rezultoi si vijon:

- **51 masa me karakter organizativ**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat 20 masa të zbatuara, 5 masa të zbatuara pjesërisht, 4 masa në proces dhe 22 masa të pazbatuara;
- **3 masa shpërblim dëmi** me vlerë **101,261,138 lekë**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë masë;
- **25 masa disiplinore**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat 15 masa të zbatuara dhe 10 masa të pazbatuara;
- **4 masa për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike** me vlerë **16,135,654 lekë**, të pranuar nga subjekti në masën 100 % por të pa zbatuara;
- **1 masë si detyrim ndaj të tretëve** me vlerë **96,096,211 lekë**, e pranuar nga subjekti por e pa zbatuar;

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Ujësjetllës Kanalizime SHA Kavajë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 1016/7 prot., datë 18.05.2020, konstatohet se pjesa më e rëndësishme e tyre është e pazbatuar. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore për masat e pazbatuara, të zbatuara pjesërisht apo në proces, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Gjetja nga auditimi: Asambleja e Aksionarëve, në rastet që është mbledhur, ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë por në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se nga problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përsheptimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 “*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura*”.

1.1.1 Rekomandimi: Asambleja e Aksionarëve, gjatë veprimtarisë së saj të marrë masa për të analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të saj.

Menjëherë

1.2 Gjetja nga auditimi: Referuar mbledhjeve të Këshillit të Administrimit për vitin 2018, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk ka një regjistër që të dokumentojë se sa herë është mbledhur Këshilli i Administrimit për periudhën objekt auditimi, por duke u bazuar në vendimet e marra nga Këshilli i Administrimit për vitin 2018, ky Këshill është mbledhur 3 herë referuar 2 vendimeve dhe 1 projektvendimi që ka marrë për këtë vit, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Këshillin e Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë UKKA SHA Kavajë, për periudhën objekt auditimi.

- Anëtarët e Këshillit të Administrimit me shoqërinë UK Kavajë SHA, nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë UK Kavajë SHA me terma të performancës;

-Referuar plotësimit të kuadrit rregullator të Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA, për vitin 2018 u konstatua se UKKA SHA Kavajë, nuk ka një statut të miratuar.

-Këshilli i Administrimit, nuk ka monitoruar, shqyrtuar dhe miratuar veprimtarinë organizative dhe funksionale të UKKA SHA Kavajë dhe vendimet e drejtimit të shoqërisë nga Administratori i UKKA SHA Kavajë për periudhën objekt auditimi;

-Është konstatuar se UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të miratuar dhe të unifikuar sipas nivelit të pagave dhe numër të miratuar punonjësish në UKKA SHA Kavajë, por referuar vendimit nr. 768/4, datë 02.08.2017 i Këshillit të Administrimit të UKKA SHA Kavajë, konstatohet se është miratuar struktura organizative e shoqërisë me 152 punonjës, ndërkohë që nga auditimi analitik i strukturës aktuale të shoqërisë UKKA SHA Kavajë, rezultojnë të punësuar 305 punonjës;

-Këshilli i Administrimit nuk ka shqyrtuar dhe nuk ka miratuar programe ekonomike për vitet 2018-2019 për shoqërinë UKKA SHA Kavajë;

-Këshilli i Administrimit ka miratuar me vonesë pasqyrat financiare për vitin 2017-2018.

Për sa më sipër për parregullsitë e konstatuara në kundërshtim me VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ngarkohet me përgjegjësi Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë UKKA SHA Kavajë, për periudhën objekt auditimi

1.2.1 Rekomandimi:

-Këshilli i Administrimit të marrë masa për shmangien e praktikave me mangësi të trajtuara, sa më sipër me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të shoqërisë.

-Nga Këshilli i Administrimit të merren masa për të hartuar kontratën e punës me Administratorin e Shoqërisë.

Menjëherë

II. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik.

2.1 Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Tregtare, Administratori dhe Këshilli i Administrimit të Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA, nuk janë miratuar programe ekonomik për vitin 2018 dhe vitin 2019 në kundërshtim me VKM nr. 63, datë 27.01.2016 dhe rregulloren e brendshme UK Kavajë SHA. Megjithëse nga Drejtoria Tregtare e shoqërisë nuk janë paraqitur projekt buxhetet të planifikuara dhe të miratuara për vitet 2018 dhe 2019, grupi i auditimit është shprehur mbi shpenzimet dhe ardhurat faktike sipas të dhënave të programit të kontabilitetit të shoqërisë, nga ku është konstatuar se shpenzimet sipas zërave të buxhetit të mbartura në programin e kontabilitetit sipas funksionit, nuk janë të njëjta me shpenzimet sipas natyrës, të cilat gjithashtu rezultojnë të mbartura në kontabilitet. Pra konstatohet se njëjti fakt është i ndryshëm në bilancin e shoqërisë dhe në zërat e shpenzimeve sipas buxhetit, për rrjedhojë mos planifikimi i programit ekonomik, ka sjellë tejkalime dhe mosrealizime në zëra të ndryshme të buxhetit të shoqërisë për vitin 2018 dhe 2019.

2.1.1 Rekomandimi: Drejtoria Tregtare të marrë masa në vazhdimësi që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë; duke raportuar çdo muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme.

Menjëherë

III. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3.1 Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i rregullores së brendshme rezulton se rregullorja e brendshme për UKKa Sh.a është miratuar në vitin 2017 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe statutin e ndryshuar të shoqërisë duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj. Në rregulloren e brendshme nuk është përcaktuar lloji i arsimimit për të gjitha pozicionet e punës si dhe nuk janë të përcaktuar qartë përshkrimi i punës për çdo pozicion, duke bërë të vështirë identifikimin e detyrave dhe të drejtave që ka çdo punonjës i shoqërisë. Janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e disa pozicioneve dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar kriteret për procedurat e marrjes në punë, konkurrimit dhe vlerësimin e kandidatëve. Përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer si rezultat i një procedure rekrutimi të ndjekur, as të kriterëve të pozicionit, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë etj. Çdo rekrutim i punonjësve gjatë periudhës objekt auditimi është kryer me urdhër të administratorit të shoqërisë dhe asnjë kriter tjetër. Nga ana e strukturave drejtuese nuk është marrë asnjë masë për përshtatjen apo hartimin e një rregulloreje të re sipas organizimit të ri në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*". Këto veprime janë në kundërshtim nenin 18, pika 2c të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, "*Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*".

3.1.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari të marrin masa për hartimin e rregullores së re të brendshme të shoqërisë ku të specifikohen qartë detyrat dhe të drejtat për çdo pozicion pune, nivelin arsimor të kërkuar për përmbushjen efiçente të këtyre detyrave si dhe të bëhet vazhdimisht përshtatja e rregullores me ri-organizimin e shoqërisë.

Menjëherë

3.1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli i Administrimit dhe Titullari të hartohen rregulla dhe procedura specifike ku të specifikohen qartë kriteret e punësimit për çdo pozicion pune lidhur me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë apo trajnimet profesionale të nevojshme për përmbushjen efikase të detyrave për çdo pozicion pune, duke rritur transparencën e mënyrës së punësimit dhe rekrutimit në bazë të meritokracisë.

Menjëherë

3.2 Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se në rregulloren e brendshme, në kontratat individuale dhe në mungesë të kontratave kolektive nuk specifikohet përmbajtja e dosjes së personelit. Në kundërshtim me VKM Nr. 63 “*Për organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*”, datë 27.01.2016, neni 18, pika b nga auditimi i dosjes së administratorit konstatohet se Z. B. T., i emëruar si Administrator i Ujësjiellës Kanalizime Kavajë Sh.a në datën 20.02.2018, nuk është pajisur akoma, me certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjiellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotur. Në asnjë nga kontratat individuale nuk specifikohet paga dhe elementet përbërës të saj. Në disa raste mungonte CV e punonjësit, diplomat universitare në pjesën më të madhe të dosjeve ishin të pa noterizuara, në disa raste mungonte librezja e punës, mungonte fleta e inventarizimit dhe librezja e sigurimeve shoqërore në të gjitha dosjet. Gjithashtu u evidentuan raste të dosjeve vetëm me kontratën e punës të personit të punësuar dhe asnjë dokumentacion tjetër. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës.

3.2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa të plotësojë të gjitha dosjet e punonjësve dhe sidomos kontrata e punës ku të specifikohet qartë pozicioni i punës në përputhje me nivelin arsimor dhe profesional të çdo punonjësi si dhe paga bruto për periudhën e punësimit. Në çdo kohë, në dosjen e punonjësit duhet të figurojnë kopje të të gjithë urdhrave të transferimit në pozicione pune të tjera brenda shoqërisë, për të rritur transparencën në afrimin e pozicioneve të punës me formimin përkatës.

Menjëherë

3.3 Gjetja nga auditimi: Nga auditimi për çeljen e fondit për ish të përndjekurit politik rezulton se Ujësjiellës Kanalizime Kavajë Sh.a nuk ka llogaritur dhe derdhur për llogari të Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2018-2019 në **shumën totale 1,835,010 lekë**. Veprimet janë në kundërshtim me shkronjën “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “*Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë*” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “*Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”*”.

3.3.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa çdo fillim viti “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe të kryhet raportimi i saktë në pasqyrat financiare, në përputhje me standardet dhe politikat kontabël të miratuara nga vetë institucioni.

-Nga Administratori i shoqërisë dhe sektori i financës të merren masa që shuma e identifikuar të mund të paguhet me këste sipas një skeduli të detajuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Menjëherë

V. Mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

5.1 Gjetje nga auditimi:

a. Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk ka miratuar pasqyrat financiare sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 14 datë 28.12.2006, i ndryshuar me urdhrin nr. 26 datë 27.12.2007 dhe mosdorëzimi i bilancit sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, ka rënduar shoqërinë me një gjobë prej 15,000 lekë.

b. Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk ka bërë transferimin e aseteve në Bashkinë Rrogozhinë, gjithashtu nuk është kontabilizuar zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë për vitin 2018, në vlerën 93,802,627 lekë vlerë e cila i takon Bashkisë Rrogozhinë në bazë të përlloraritjeve të ekspertëve kontabël të miratuar në raportin “*Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë*”, datë 12.02.2018, për sa më sipër vlera 93,802,627 lekë rëndon në mënyrë të padrejtë zërin e bilancit aktive afatgjata materiale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

c. Bilanci i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë për vitin 2018, nuk kuadron në llogaritë e gjendjeve sepse totali i bilancit i raportuar nga shoqëria për vitin 2018 është në vlerën 2,706,139,177 lekë , ndërsa sipas programit të kontabilitetit totali i bilancit rezulton në vlerën 2,707,071,100 lekë me një diferencë në vlerën 931,923 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i moskuadrimin të hedhjes së të dhënave në programin e kontabilitetit të shoqërisë duke raportuar një mospërputhje të të dhënave në programin e kontabilitetit dhe në bilancin e raportuar, duke ulur shkallën e besueshmërisë të ngjarjeve dhe fakteve në kontabilitetin e shoqërisë dhe rezultatit financiar, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 date 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhrin nr. 26 datë 27.12.2007, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat , i ndryshuar, neni 33/1”, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe SKK2.

5.1.1 Rekomandimi: Shoqëria UK Kavajë SHA të marrë masa për kontabilizimin e zvogëlimit të kapitalit duke marrë në konsideratë rezultatit financiar (humbjen) e miratuar në Këshillin e Administrimit dhe duke e shpërndarë këtë humbje 80.5 % në UK Kavajë SHA dhe 19.5 % Bashkisë Rrogozhinë, duke kryer edhe transferimin e aseteve nga UK Kavajë SHA në Bashkinë Rrogozhinë.

Menjëherë

5.2 Gjetje nga auditimi: Shoqëria UK Kavajë SHA në rolin e agjencisë zbatuese sipas marrëveshjes së huas miratuar me ligjin Nr. 9042 datë 03.04.2003, ka ndërtuar impiantin e prodhimit të ujit të pijshëm në Manskuri. Ky impiant është projektuar që të furnizojë zonën e plazhit Golem si dhe shitje me shumicë për Ujësjellës Kanalizime Durrës. Ndërtimi i tij është financuar nga huaja 2,045,167.52 Euro dhe granti 1,533,875.64 Euro i marrë nga Qeveria

Gjermane (Banka KfW). Punimet e impiantit janë kryer në lotin A ku përfshihen 1. Ndërtimi i tre filtrave të rërës 1200 m³, 2. Rezervuari dhe stacionet e pompimit, sistemi automatik i klorinimit. Punimet kanë përfunduar më 04.07.2007 dhe janë marrë në dorëzim me “Certifikatë of Handing Over” datë 14.09.2007 firmosur nga kontraktori, konsulenti dhe klienti (Drejtori i UKK Z. H. Sh.). Nga auditimi është konstatuar se Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk ka llogaritur kostot e mirëmbajtjes dhe të amortizimit të impiantit të prodhimit të ujit të pijshëm në Manskuri, nuk ka kthyer asnjë kështu si principal ashtu edhe interesa për huanë e dhënë sipas kushteve të marrëveshjes së huas, gjithashtu nuk ka gjurmë në bilancin e shoqërisë UKKA SHA të kontabilizimit të disbursimit të kredisë së dhënë, në kundërshtim me ligjin Nr. 9042 datë 03.04.2003 "Marrëveshja e huas, e financimit dhe e projektit “Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)”.

5.2.1 Rekomandimi: Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrin masa për të nxjerrë të dhënat e plota mbi akordimin e kredisë nga shteti shqiptar dhe nga Banka Gjermane, të evidentojë disbursimin e saj, me bankën e nivelit të dytë me të cilën është bërë disbursimi, likuidimi i principalit, llogaritjen e kostove të mirëmbajtjes, amortizimit dhe interesave, që kjo kredi të shlyhet brenda vitit 2042, siç është përcaktuar në marrëveshjen e qeverisë shqiptare me bankën gjermane.

Menjëherë

5.3 Gjetje nga auditimi: Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë në zërin “të ardhura të shtyra” ka një vlerë 1,720,430,086 lekë, origjina e të cilës nuk është e argumentuar në të dhënat e programit të kontabilitetit kjo shifër është 108 lekë. Diferenca prej 1,720,430,068 lekë rezulton të jetë një vlerë e mbartur në vite në bilanc. Kjo vlerë mund të ketë ardhur si rezultat i mos deklarimit të të ardhurave të muajit dhjetor të çdo viti i raportuar në janarin e vitit të ardhshëm apo të ndonjë natyre tjetër që nuk është kuadruar midis Drejtorisë së Shitjes dhe Drejtorisë Tregtare në UK Kavajë SHA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, SKK nr. 5 “Për të ardhurat e shtyra”.

5.3.1 Rekomandimi: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA, të marrin masa të argumentojnë dhe të sistemojnë vlerën 1,720,430,068 lekë në programin e kontabilitetit të shoqërisë.

Menjëherë

5.4 Gjetje nga auditimi:

-Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë në zërin “Rezerva të tjera “për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: 0 ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: 1,702,411,755 lekë. Ekziston një diferencë prej 1,702,411,755 lekë. Për vlerën 1,702,411,755 lekë, nuk jepen sqarime në llogarinë e saj, por e sjellin me gjendje të mbartur nga vitet e kaluara.

- Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë për zërin “Fitim /Humbje e vitit“ për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: -8,968,840 lekë ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: -10,643,159 lekë. Ekziston një diferencë prej -1,674,319 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, SKK5”Për të ardhurat e shtyra”.

5.4.1 Rekomandimi: Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA të marrë masa që të evidentojë dhe analizojë nga bilancet e viteve të mëparshme ecurinë e llogarisë “Fitim/humbje” duke paraqitur

arsyet e aktivitetit me humbje si dhe të sistemojve llogarinë “Rezerva të tjera“ për vlerën 1,702,411,755 lekë, që në bilancin e vitit 2018 paraqitet me gjendje zero.

Menjëherë

5.5 Gjetje nga auditimi: Moskuadrimi i llogarive të ardhura dhe shpenzime gjithsej në shoqërinë UK. Kavajë SHA për vitin 2018 ndërmjet bilancit dhe llogarive të gjendjeve në programin e kontabilitetit Alfa. Llogaria “Te ardhura gjithsej” për vitin 2018 në Pasqyrën financiare ë raportuar vlera është: 327,169,258 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie ne programin e kontabilitetit është: 326,974,038 lekë. Ekziston një diference prej 195,220 lekë. Llogaria “Shpenzime gjithsej” për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare të raportuar vlera është: 336,138,098, ndërsa gjendja e kësaj llogarie në programin e kontabilitetit është: 337,617,198 lekë Ekziston një diference prej 1,479,100 lekë. Llogaria e të ardhurave ka moskuadrime ne llogarite “Te ardhura Financiare” për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare të raportuar vlera është: 32,146,963 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie në programin e kontabilitetit është: 31,951,743 lekë. Ekziston një diferencë prej 195,220 lekë, si dhe ne Llogarinë “Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit“ për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare të raportuar vlera është: 165,726,667 lekë ndërsa gjendja e kësaj llogarie ne programin e kontabilitetit është: 165,713,708 lekë. Ekziston një diference prej 12,959.00 lekë. Për sa u përket shpenzimeve diferencat kane ardhur si rezultat i mos raportimit të sakte të blerjeve, llogaria “Shpenzime Lëndë e parë dhe material te konsumueshme” (KMSH) për vitin 2018 në Pasqyrën financiare të raportuar vlera është: 116,976,428 lekë. Ne programin e kontabilitetit vlera e blerjeve te riregjistruara për vitin 2018 është: 117 969 255 lekë. Ndërsa ne bilancin e raportuar vlera e blerjeve është: 112,322,413 lekë. Këto moskuadrime kane sjelle dhe mos kuadrimin e sakte te humbjes ne shoqërinë UK. Kavaje SHA. Kjo ka ardhur si rezultat i mos zbatimit plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Ligji nr. 10296 date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Ligji nr. 10296 date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

5.5.1 Rekomandimi: Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, duhet të evidentojë nga bilancet e viteve të mëparshme si ka qenë ecuria e llogarive të ardhura dhe shpenzime dhe të sistemojve për vitin 2018 dhe në vazhdim klientët që kanë bërë arkëtime, por nuk ju është kontabilizuar detyrimi i tyre ndaj shoqërisë d.m.th. fatura e shitjes.

Menjëherë

VI. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

6.1 Gjetje nga auditimi: Në 3 procedura prokurimi për vitin 2018 në vlerën 8,828,939 lekë dhe 1 procedurë për vitin 2019 në vlerën 4,299,900 lekë, nuk ka gjurmë të studimit të tregut, referim të kontratave të ngjashme, apo të dhëna referuar INSTAT, për të bërë të qartë mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit të kësaj procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

-Për një procedurë prokurimi për vitin 2019 ”Blerje Karburanti” me vlerë 4,299,900 lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk është përcaktuar kufiri për marzhin e fitimit dhe nuk ka asnjë dokument që argumenton mungesën e përcaktimit të këtij elementi në DST, i cili shërben si kufi për të mbajtur një çmim të arsyeshëm dhe me ekonomikitet për shoqërinë duke minimizuar

kostot e panevojshme. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit në vlerën, 2,954,789 lekë “Blerje Karburanti” për vitin 2018, referuar sistemit elektronik të APP, në skedarin e vlerësimit është konstatuar se dy nga anëtarët e KVO-së, nuk e kanë kualifikuar operatorin ekonomik A&T sh.p.k, megjithatë në kualifikimin përfundimtar ky operator është shpallur fitues i kësaj procedure. Në dosjen shkresore të prokurimit nuk gjendet asnjë gjurmë e cila justifikon kualifikimin e këtij operatori të shpallur fitues, gjithashtu KVO nuk ka dokumentuar me raport përmbledhës të nënshkruar nga çdo anëtar i KVO, vazhdimin e procedurës për miratim nga titullari i AK. Për sa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

-Në 7 procedura me blerje të vogël për vitin 2018 në vlerën 5,031,500 lekë dhe 10 procedura me blerje të vogël për vitin 2019 në vlerën 6,488,499 lekë , në të gjitha rastet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve të planifikuara dhe jo të planifikuara , u konstatua se kërkesa e bërë për mallin apo shërbimin ishte formale pa argumentin e nevojës së kryerjes së shpenzimit nga specialistë të fushës dhe ku shpesh herë kjo kërkesë nuk kishte konfirmimin e magazinierit. Gjithashtu marrja në dorëzim e mallrave referuar procedurave me blerje me vlerë të vogël konfirmonte thjesht marrjen në dorëzim (konfirmim që e bën dhe magazina me fletë hyrjen e mbajtur) dhe jo marrjen në dorëzim konform specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit janë të pasakta nga ana e rregullave të arkivimit, kjo në kundërshtim me ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, dhe në Rregulloren “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH”, neni 13.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nuk gjenden deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruara nga anëtarët e komisioni të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me, VKM Nr. 914, date, 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 11.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit, blerje me vlerë të vogël për periudhën 2018-2019, janë pasqyruar dhe kanë kryer veprime në sistemin elektronik APP, “Njësi Prokurimi” dhe “Komision Vlerësimi të Ofertave”, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël”, i ndryshuar.

- Në 7 procedura prokurimi për vitin 2018, blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,031,500 lekë (pa TVSH) dhe në 7 procedura prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,586,925 lekë (pa TVSH), konstatohet se: Znj. F. Gj. me detyrë Drejtor Tregtar i Shoqërisë UKK është njëkohësisht edhe kryetare komisioni e blerjes me vlerë të vogël, në kundërshtim me ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 22, pika 5.

- Në 1 procedurë prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 800,000 lekë (pa TVSH), specifikimet teknike (vizatimet) janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 14, pika 2, paragrafi 3.

- Autoriteti Kontraktor Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë sh.a për periudhën objekt auditimi viti 2018 dhe viti 2019, për çdo artikull mallrash të blerë nën vlerën 100,000 lekë (rreth 234 urdhra prokurimi), ka përdorur ligjin e prokurimit publik pavarësisht vlerës së mallit duke i trajtuar si blerje emergjente të cilat nuk i ka pasqyruar as në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike dhe nga mungesa e një plani ekonomik të detajuar sipas nevojave të çdo sektori, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 2, paragrafi 2 ku thotë në mënyrë eksplicite: “Për prokurimet, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100,000 lekë deri në 800,000 lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 40 të këtyre rregullave. Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100,000 lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatumor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë”.

- Staf i organizimit të Procedurave të Prokurimeve në Ujësjetllës Kanalizime Kavajë nuk ka kryer asnjë trajnim pranë APP për periudhën objekt auditimi në kundërshtim me LPP (Ligjin për Prokurimin Publik) dhe VKM nr. 914 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

6.1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për planifikimin e programeve të trajnimit për stafin në lidhje me procedurat e prokurimit dhe përdorimin e sistemit elektronik të APP.

Menjëherë

VII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe Auditin e Brendshëm

7.1 Gjetje nga auditimi: Grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura, dhe për komponentin e parë të MFK, për mjedisin e kontrollit u konstatua që: Administratori i Shoqërisë UKKa, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Këshillin Teknik të Shoqërisë UKKa. Shoqëria UKKa nuk ka hartuar plan biznesi afatgjatë, duke operuar pa program ekonomik për periudhën objekt auditimi. Shoqëria UKKa është e pa orientuar strategjikisht. Mungesa e Planit të biznesit ka ndikuar në përcaktimin e objektivave strategjik, të cilat duhen të jenë specifike, të matshëm dhe me afate kohore të përcaktuara. UKKa, nuk e ka miratuar statutin e shoqërisë nga Këshilli i Administrimit. Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Strukturave dhe Detyrave në Ujësjetllës Kanalizimin SH.A., Kavajë, e miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit Nr. 97/5 Prot. datë 10.02.2017, është në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 63 date 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, pasi: a) Rregullorja e Brendshme e UKKa, ka mos përputhje me strukturën organizative të miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 Prot. datë 02.08.2017; b) Rregullorja i referohet UKD (Ujësjetllës Kanalizime, Durrës) dhe jo Ujësjetllës Kanalizime, Kavajë; c) Rregullorja i referohet Këshillit Mbikëqyrës dhe jo Këshillit të Administrimit, si organ drejtues në Shoqërinë UKKa. Administratori i shoqërisë për periudhën respektive brenda objektit të auditimit, nuk ka deleguar kompetencat ose detyrat anëtarëve të caktuar të stafit drejtues, sipas objektivave dhe detyrave të shoqërisë, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit për MFK. Përgjatë vitit

2018-2019, nr. i përgjithshëm i punonjësve të UKKa, rezulton të ketë rritje në krahasim me numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 Prot. datë 02.08.2017. Administratori përkatës për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit, brenda periudhës objekt auditimi, ka rritur numrin e strukturës organizative me punonjës përtej numrit të përgjithshëm të strukturës së miratuar nga KA, dhe në fund të vitit 2019, Shoqëria UKKa rezulton me 304 punonjës.

-Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kavajë në fund të vitit 2019, rezulton me 25,124 lidhje (abonentë), pra çka tregon që UKKa ka 12.5 punonjës për 1,000 lidhje, duke e renditur UKKa me treguesin më të lartë të nr. të punonjësve për 1,000 lidhje krahasuar me standardet dhe mesataren kombëtare të ujësjetllës kanalizimeve në vend, që është rreth 4.5-6 punonjës për 1,000 lidhje. Administratori i Shoqërisë UKKa, për periudhën respektive brenda periudhës objekt auditimi, nuk ka kryer vlerësime periodike të stafit të shoqërisë (ngritje ose ulje në detyrë) mbi performancën dhe realizimin e detyrave të punonjësve, mbi bazën e përshkrimeve të detyrave në kontratën e punës dhe rregulloren e përgjithshme. Sektori i marrëdhënieve me publikun pranë shoqërisë UKKa, trajton ankesat e qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar. Qytetarët që kanë ankesa për shërbimin e ofruar nga Shoqëria UKKa, paraqiten pranë këtij sektori duke plotësuar formularin e ankesave. Punonjësit e këtij sektori i regjistrojnë ankesat e qytetarëve manualisht dhe jo në sistemin informatik "Albilling", i cili mundëson regjistrimin e tyre në modulën "regjistrimi i ankesave". Për vitin 2018 në Shoqërinë UKKa, janë regjistruar 77 ankesa të përgjithshme (kryesisht ankesat janë për mbifaturim) dhe 61 ankesa për probleme inxhinierike. Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 131 ankesa të përgjithshme dhe 116 për probleme inxhinierike. Trajtimi i ankesave të qytetarëve bëhet nga departamente/ drejtori/ sektor përkatës ku është adresuar ankesa. Shoqëria UKKa, nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit për arkivat dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për sistemin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. Nga auditimi u konstatua që: a) dokumentet e arkivuara nuk janë të dokumentuara në regjistrin e hyrjeve-daljeve; b) nuk janë përpiluar pasqyrat emërtuese në regjistër, në bazë të gjitha kriterëve arkivore të cilat janë: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes territoriale-administrative, të llojit të dokumentit, të kohës; c) pasqyra emërtuese nuk është miratuar nga administratori i shoqërisë.

7.1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e statutit, rregullores së brendshme dhe plan biznesit afatgjatë.

Menjëherë

7.1.2 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të miratoj pasqyrën emërtuese për dosjet e arkivuara dhe të marrë masa për regjistrimin e tyre.

Menjëherë

7.2 Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit për menaxhimin e riskut, u konstatua që: Shoqëria UKKa nuk ka hartuar regjistër rrishtu për identifikimin, kategorizimin, ndjekjen dhe minimizimin e risqeve që mund të shfaqen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj. Shoqëria nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë një raport vjetor mbi problematikat e hasura. Koordinatorin e riskut nuk është emëruar, por funksionet e tij, i kryen Administratorin e shoqërisë sipas përcaktimeve në MFK.

7.2.1 Rekomandimi: Administratorin e shoqërisë në bashkëpunim me Këshillin e Administrimit të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e politikave të menaxhimit të riskut.

Menjëherë

7.3 Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për “*aktivitet e kontrollit*”, u konstatua që: Shoqëria UKKa nuk ka përgatitur hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditit, nuk ka të regjistruar asetet e saj dhe nuk ka evidentuar vlerat e aktiveve afatgjata, të cilat nuk janë të përditësuara në një regjistër të posaçëm në lidhje me kronologjinë e vlerës ndër vite, rivlerësimin, amortizimin etj., probleme të mbartura ndër vite. Administratori i shoqërisë nuk ka paraqitur deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të UKKa, si edhe Raportin e Vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Shoqëria UKKa, përdor sistemin informatik “*Albilling*” për faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave. Nga analizimi i raporteve që gjeneron sistemi konstatohet që, ka problematika si në drejtim të numrit të limituar të raporteve që gjenerohen, por dhe në drejtim të cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave. Gjatë analizimit të të dhënave p.sh., duke krahasuar të dhënat e një abonenti mbi bazën e numrit të kontratës, rezulton që në paraqitjen e “*raportit mujor të arkëtimit*” dhe “*raportit mujor me zëra*”, rezultojnë të dhëna të ndryshme. Gjithashtu në raportet e gjeneruara nga sistemi informatik “*Albilling*”, gjatë eksportimit të të dhënave në formatin “*excel*”, ato nuk ruajnë parametra të njëjtë të renditjes për çdo muaj. Sistemi informatik “*Albilling*”, nuk ka “*backup*” të bazës së të dhënave, duke cenuar sigurinë e tyre. UKKa, nuk ka hartuar rregullore në nivel administrimi për përdoruesit e sistemit “*Albilling*”. Në sistemin informatik “*Albilling*” nuk pasqyrohen abonentët pa matësa. Në rubrikën “*raport mbi abonentët*” nuk pasqyrohet nr. i abonentëve me dhe pa matësa. Në fund të vitit 2019, nr. i abonentëve familjare pa matësa ishte 17,077, kjo e dhënë është marrë nga Drejtoria e Shitjeve pranë UKKa dhe jo nga sistemi, i cili nuk e pasqyron këtë të dhënë. UKKa nuk ka laborator për kryerjen e analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike për monitorimin e cilësisë së ujit, në kundërshtim me VKM 379 datë 25.05.2016. Për miratimin e rregullores “*Cilësia e ujit të pijshëm*”. Laboratori i analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike në ITUN pranë UKKa, nuk funksionon. Sistemi SCAD funksionon vetëm në pikën e furnizimit me ujë, në Çermë të Lushnjës. Ky sistem nuk është i shoqëruar me manual shpjegues, dhe nuk gjeneron raporte mbi treguesit kryesor. Sistemi SCAD nuk gjeneron *log-in* për të evidentuar gjurmimin në kohë të funksionimit të kësaj pike furnizimi të UKKa, me ujë të pijshëm. Sistemi SCAD në ITUN nuk funksionon.

7.3.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë UKKa, të kërkojë nëpërmjet Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme, përfshirjen në programet e auditimit të NjAB të Bashkisë Kavajë edhe Shoqërinë UKKa.

Menjëherë

7.4 Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për “*Informacioni dhe komunikimi*”, u konstatua që:

- Në Rregulloren e brendshme të shoqërisë UKKa, nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të UKKa. Komunikimi i brendshëm dhe jashtë institucionit, bëhet me adresa personale dhe jo me e-mail zyrtar. UKKa, nuk posedon faqe Web-i zyrtar. Shoqëria UKKa, nuk ka të publikuar online programin e transparencës, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*”. Zyra e marrëdhënieve me publikun, pranë UKKa nuk shfrytëzon sistemin informatik “*Albilling*” për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave të qytetareve. Shoqëria UKKa, nuk ka përcaktuar procedura mbi mënyrën e raportimit ditor apo periodik mbi ecurinë dhe realizimin e treguesve ekonomik financiar të shoqërisë.

7.4.1 Rekomandimi: Shoqëria të krijoj faqen e web-it zyrtar, ku të pasqyrojë edhe programin e transparencës, si dhe komunikimi elektronik brenda dhe jashtë institucionit të kryhet me adresë e-mail zyrtar.

Menjëherë

VIII. Zbatimi i standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura që shkarkohen në mjedis.

8.1 Gjetje nga auditimi: Shoqëria “Ujësjetës Kanalizime Kavaje” sh.a kryen veprimtarinë me objekt prodhimin, grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura. Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës, enteve private (biznesit) dhe institucioneve shtetërore është me ngritje mekanike, burimet janë ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Uji prodhohet nga, stacioni i pompimit Çermës me gjashtë kaptazhe (puse), stacioni i pompimit Harizaj me tre kaptazhe (puse) si dhe impianti i përpunimit të ujit të pijshëm Maskuria që burim (ujëra sipërfaqësor) ka ujëmbledhësin “Rezervuari i Maskurisë”. Stacioni i pompimit të Çermës furnizon depon kryesore që shërben për qytetin e Kavajës dhe depon e Maskurisë gjatë sezonit turistik ku kërkesat për ujë të pijshëm janë të mëdha. Stacioni e Pompimit Harizaj furnizon me ujë të pijshëm depot që shërbejnë për zonën rurale.

-Nga vizita ne terren e grupit te auditimit në Stacionin e Pompit të Çermës dhe kaptazheve (pusçpimet) u konstatua se: kaptazhet (veprat e marrjes së ujit) janë në oborrin e shtëpive private të cilat nuk janë të lidhura me një sistem kanalizimesh për largimin e ujërave të ndotura. Ujërat e ndotura grumbullohen në gropa septike të cilat nuk janë të izoluar. Gjithashtu në oborrin e shtëpive, ku ndodhen kaptazhet (puset e ujit) ka dhe stalla bagëtish që mbarështohen nga pronarët. Për të gjitha puset nuk është realizuar plotësisht mbrojtja higjieno-sanitare e kaptazheve (burimet nëntokësore) veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, neni 11, shtojca IV “Zonat e mbrojtjes sanitare” pika 2 “Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore”.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se: dezinfektimi i ujit të pijshëm bëhet me metodën kimike me produktet dezinfektuese, hipokloriti i kalciumit dhe hipokloriti i natriumit. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i natriumit bëhet në mënyrë automatike me dozim, në varësi të prurjeve nga kaptazhet, në stacionin e pompimit Çermë. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i kalciumit bëhet në shuarësin e presionit në qytetin e Kavajës si dhe në depon Golem. Nga auditimi i dosjeve të personelit të vëna në dispozicion, administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, për punonjësit që kryejnë dizinfektimin e ujit në periudhën objekt auditimi, Depo/shuarësi i presionit Kavajë, Specialisti i Pompimit Çermë dhe Specialisti i Depos Golem, konstatohet se nuk gjenden dëshmi të gjendjes shëndetësore të tyre, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm”, neni 17. Gjithashtu konstatohet se nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit.

8.1.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë duhet të marrë masat e nevojshme që analizat e përbërjes fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm për kaptazhet, të kryhen në mënyrë periodike dhe në varësi të ndotjes që krijohet brenda zonës 1, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit si dhe kryerjen e analizave te produkteve dezinfektuese nga ana e ISHP, sipas legjisllacionit ne fuqi (VKM Nr. 379, datë 25.05.2016, “Për miratimin e rregullores Cilësia e Ujit të Pijshëm”, neni 14, pika 4), para se ato të përdoren për trajtimin e ujit te pijshëm.

Menjëherë

8.1.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe organet drejtuese duhet të marrin masat e nevojshme që punonjësit, të cilët kryejnë dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe janë në kontakt me ujin e pijshëm të jenë të pajisur me dëshmi të gjendjes shëndetësore sipas rregullores për pajisjen me librezë shëndetësore profesionale.

Menjëherë

8.1.3 Rekomandimi: Shoqëria në bashkëpunim me ISHP të hartojë një rregullore (metodikë) të kryerjes të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm, në burimet e ujit dhe sistemin shpërndarës, gjithashtu hartimin e një protokollit se si duhet të veprohet në rastet e ndotjes, marrjen e masave në mënyrë rigorozë dhe të menjëhershme, për mbrojtjen e shëndetit publik.

Menjëherë

8.2 Gjetje nga auditimi: Shoqëria e “Ujësjetës Kanalizime Kavajë” Sh.a. kryen shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për qytetin e Kavajës dhe zonën e plazhit Golem. Largimi i ujërave të ndotura nga qyteti i Kavajës bëhet me vetërrjedhje dhe për zonën Golem me ngritje mekanike nëpërmjet gjashtë stacioneve të pompimit pa presion. Sistemin i kanalizimeve mbledh ujërat e ndotura të familjareve, bizneseve private dhe aktiviteteve industrialeve dhe trajtohen nga impianti i pastrimit të ujërave të ndotura. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Kavajë, është i pari impiant i këtij lloji i ndërtuar në Shqipëri pas viteve 90, ka filluar të funksionojë që nga Tetori i vitit 2005. Vendndodhja e ITUN është në fshatin Qerret, në një distancë 0,6 km larg bregut të detit dhe afërsisht 6 km larg nga qendra e qytetit të Kavajës. Impianti përdor për trajtimin e ujërave të ndotura metodën biologjike, konkretisht metodën e trajtimit me filtër biologjik, të llojit filtër me pikim. Në vitin 2015 kanë përfunduar punimet për zgjerimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura që vijnë nga zona Plazh Golem, për të patur një funksionim fleksibël për të përballuar një shkallë të gjerë prurjesh dhe karakteristikash të ujit të ndotur. Nga grupi i auditimit në ITUN u konstatua se impianti nuk i kryen të gjitha proceset për pastrimin e ujërave të ndotura, konkretisht:

-Trajtimi paraprak, kryen procesin e eliminimit të mbetjeve dhe copërave të madha, rëmbledhësi për eliminimin e materialit të trashë në suspensë dhe yndyrëmbledhësi për largimin e vajrave dhe yndyrës. Pajisjet që kryenin këtë proces janë në gjendje pune por kërkojnë mirëmbajtje të tyre për vazhdimësinë e trajtimit të ujërave të ndotura.

-Trajtimi primar përfshin largimin e pjesshëm të lëndëve në suspensë dhe lëndëve organike me anë të metodave fizike të tilla si sedimentimi, flotimi dhe sitimi. Për të përmirësuar trajtimin primar ose ndryshe trajtimi me fotosinteze përdoret flokulimi i para-ajruar. Në dekantuesin primar, ajrosja, largimi i llumit dhe kalimi i materialit për t’ju nënshtruar proceseve të tjera kryhet nga dy pajisje lundruese (draga) të cilat lëvizin me telekomandë. Nga grupi i auditimit u konstatua se këto dy pajisjet lundruese dhe aparaturat (pompa, përzierësi dhe tubat) ishin për një kohë të gjatë jashtë funksionit, këtë e tregonte korrozioni i tyre, e për rrjedhojë proceset e tjera të trajtimit nuk kryheshin.

-Trajtimi sekondar kryhen largimin i lëndëve organike të tretura dhe koloidale, si dhe i lëndëve të ngurta në suspensë që e kanë kaluar trajtimin primar. Nga grupi i auditimit u konstatua se ky proces nuk kryhej për arsye se pompat dhe tubacionet janë jashtë funksionit.

-Trajtimi terciar e kalon nivelin e trajtimit tradicional sekondar për të larguar sasi të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve. Në këtë proces trajtohet materiali nga dekantuesi primar pasi janë veçuar materialet e ngurta. Nga

grupi i auditimit u konstatua se ky proces nuk kryhej për arsye se pompat dhe tubacionet janë jashtë funksionit.

-Trajtimi i llumit i cili përmban lëndë të ngurta organike dhe inorganike që janë larguar nga rrjedha e ujit me anë të dekantuesit primar dhe lëndët organike të prodhuara gjatë trajtimit sekondar biologjik dhe të larguara me anë të dekantuesit sekondar, trajtohet në mënyra të ndryshme. Nga grupi i auditimit u konstatua se llumi nuk trajtohej. Gjithashtu u konstatua se, llumi dhe materialet e ngurta nga dekantuesi primar nuk është larguar për një kohë të gjatë duke zvogëluar sasinë përpunuese e duke dëmtuar bazamentin e tij. *Shkarkimi i ujërave të ndotura, pas dekantimit mekanik në ITUN Qerret, derdhen në detin Adriatik. Bazuar në kushtin që trajtimi i ujërave të ndotura është përdorimi i metodave fizike, kimike dhe biologjike, trajtim i cili mungon në ITUN Qerret.* Në ITUN ka sistem të kontrollit “SKADA” që shërben për komandimin e gjithë procesit në mënyrë automatike si dhe gjeneron të dhënat e nevojshme. Nga grupi i auditimit u konstatua se sistemi SCADA është jashtë funksionit si dhe shoqëria nuk ka staf specialist për përdorimin e tij.

Laboratori i ITUN duhet të kryej analizat e ujërave të ndotura, në nyje të ndryshme të procesit, sipas skemës funksionale dhe metodës biologjike që është projektuar. Analizat që duhet të kryhen janë vlerat e NKO-së (Nevoja Kimike për Oksigjen) dhe të NBO-së (Nevoja Biokimike për Oksigjen) të shprehura në mg/l O₂ si dhe lënda e ngurtë pezull e shprehur mg/l. Nga grupi i auditimit u konstatua se laboratori nuk kryen analizat e kërkuara, në staf nuk ka punonjës laborant sipas strukturës si dhe reagentët që gjendeshin në laboratorin e impiantit ishin të skaduar. Nga ish laborantja Znj. J. Gj. nuk janë kryer analizat e ujit të ndotur në të gjitha fazat dhe nuk ka mbajtur regjistra të saktë për shkarkimin e ujërave në mjedisin pritës.

Gjithashtu nga grupi i Auditimit u konstatua se, të gjitha pompat janë jashtë funksionit, ka çarje të tubacioneve të filtrimit, pajisjet elektrike kanë probleme të theksuara dhe pajisja për kryerjen e procesit filtrim me pikim janë jashtë funksionit.

Për sa më sipër, ITUN Kavajë nuk kryen proces të plotë të trajtimit të ujërave të ndotura, kryen procesin paraprak dhe atë primar jo të plotë, kështu që nuk jep rezultatin e pritshmërisë së investimit, nuk plotëson normat dhe standardin e cilësisë që duhet të plotësoj uji i trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 177, dt. 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC.

8.2.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë, të krijojë një grup pune me specialist të fushës përkatëse për evidentimin e problemeve në ITUN. Gjithashtu të evidentohen nevojat e kërkesat, dhe të hartohet një plan pune i detajuar, sipas të gjitha proceseve, për vënien në efikasitet të plotë të ITUP në një kohë sa më të shkurtër.

Menjëherë

8.2.2 Rekomandimi: Të vihet në funksionim laboratori në ITUN, sipas standardeve shtetërore, dhe të kryhen në mënyrë rigorozë e të vazhdueshme analizat e ujit të ndotur që shkarkohet në mjedisin pritës.

Menjëherë

8.2.3 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë të evidentohen dhe të krijohet një regjistër për të gjitha subjektet komerciale dhe industriale që shkarkojnë ujin e ndotur në sistemin publik të kanalizimeve. Nga ana e shoqërisë të kërkohet/monitorohet kryerja e analizave të ujërave të ndotura, nga vetë subjektet komerciale dhe industriale, në zbatim të standardeve shtetërore, për të

ulur koston e përpunimit të ujërave të ndotura në ITUP. Në rast të moskryerjes së analizave të merren masa administrative ndaj këtyre subjekteve, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

8.3 Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 deri 06.09.2018 operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë ka kryer veprimtari të pa licencuar në të gjitha kategoritë, A,B,C e D, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Për kryerjen e veprimtarisë të pa licencuar, në të gjitha kategoritë, nga operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU me Vendim Nr. 42, datë 13.06.2018 ka dënuar me gjobë në shumën 300,000 lekë për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë dhe në shumën 100,000 lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj ERRU, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për mospagim të detyrimeve financiare ndaj ERRU, Përmbaruesi Gjyqësor G. F. me shkresën Nr. 65/42 Prot. datë 02.07.2018, ka nxjerrë “Urdhër për vënien sekuestro konservative” në zbatim të Urdhrit Ekzekutues Nr. 5583/U datë 03.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në shumën 5,346,470 lekë. Nga dokumentet financiare të vendosura në dispozicion konstatohet se detyrimi i mbartur ndaj ERRU, deri në përfundim të auditimit, është 5,779,600 lekë. Shoqëria e UK Kavajë është e licencuar nga ERRU (Enti Rregullator i Ujit) me Vendimin Nr. 65, datë 06.09.2018, me mbarim afati 05.09.2022. sipas licencës operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë autorizohet të kryej veprimtarinë përkatëse për kategoritë, A-për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik, B-për përpunimin e ujit për konsum publik, C-për largimin e ujërave të ndotura. Nga grupi i auditimit u konstatua se, për kategorinë D-për përpunimin e ujërave të ndotura, operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kavajë kryen veprimtari të pa licencuar në Impiantin e Përpunimit të Ujërave të Ndotura. Mos licensimi për kategorinë nga ana e ERRU është si rezultat se shoqëria UK Kavajë nuk është pajisur me Leje Mjedisore për ITUN kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, seksioni 2, neni 29, pika 1.

8.3.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë, Këshilli Administrimit të marrin masa për përgatitjen e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pajisje me Leje Mjedisore për ITUN që është kusht paraprak për licencimin e shoqërisë nga ana e ERRU për përpunimin e ujërave të ndotura

Menjëherë

8.3.2 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë të arrihet në një marrëveshje me ERRU, për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe ato të prapambetura, duke shmangur bllokimin e llogarive bankare të cilat për rrjedhojë vendosin shoqërinë në vështirësi financiare.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i listë-pagesave për periudhën objekt auditimi 2018-2019 u konstatua një tejkalim i strukturës së shoqërisë nga ajo e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ deri në 150 punonjës mbi strukturë (gjatë muajve; tetor, nëntor, dhjetor, 2019 numri total i punonjësve ka arritur mbi 315 punonjës nga 152 punonjës që ka në strukturë e miratuar) duke i shkaktuar shoqërisë për vitet 2018-2019 një **dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi në paga në shumën 79,388,728 lekë** dhe për efekt zinxhir në sigurime shoqërore vlera e

dëmit ekonomik pa mundësi arkëtimi është **10,414,628 lekë** dhe e TAP prej **3,180,845 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me strukturën e miratuar nga Këshilli i Administrimit i UKKa SH.A, Pika "b" e Nenit 134, neni 154 "Të drejtat dhe detyrimet" ligj nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", statutin tip të shoqërisë së UKKa SH.A, në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", rregulloren e brendshme e UKKa Sh.a dhe kontratat individuale të punës. Për këto veprime mban përgjegjësi ish Administratori i UK Kavajë SHA z. B. T. për periudhën 15.08.2019-31.12.2019.

1.1 Rekomandimi: Shoqëria dhe Drejtoria e Financës duhet të marrë masa për shqyrtimin e **dëmit ekonomik pa mundësi arkëtimi** në vlerën totale **92,984,201 lekë**, të ardhur si pasojë e punësimeve mbi strukturë, për evidentimin e përgjegjësive, për shmangien e kostove të cilat mbartin risk të lartë për efekt negativ financiar në të ardhmen pasi shoqëria figuron me humbje që prej vitit 2015 dhe kryerjen e menaxhimit efikas për rritjen e rentabilitetit të shoqërisë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës. Kartelat për tërheqjen e karburantit janë nënshkruar nga titullari i UK Kavajë për periudhën objekt auditimi ose personi i autorizuar në formë verbale nga Titullari i UK Kavajë SHA, sipas periudhës objekt auditimi. Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkruar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patentat shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina. Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinum në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019 nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr. 01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr. 01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra. **Për rrjedhojë vlera 8,183,337 lekë, përbën dëm ekonomik të mundshëm për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, dhe n.q.s nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga ish Administratorët e UK Kavajë SHA z. H. T. për periudhën 01.01.2018-1.08.2019, z. E. D. për periudhën 2.08.2019-13.08.2019, Administratori i UK Kavajë SHA z. B. T. për periudhën 15.08.2019-31.12.2019, përgjegjësit e shpërndarjes së karburantit znj. R. B. për periudhën 11.03.2019-31.07.2019, Znj. F. Gj. për periudhën 21.07.2019-31.08.2019, z. M. Sh. për periudhën 21.08.2019-31.12.2019 dhe z. N. C. me detyrë magazinier, për periudhën 1.01.2018-31.12.2019.**

2.1 Rekomandimi: Nga Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, të ndiqen të gjitha hapat ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës **8,183,337 lekë** e cila përbën dëm ekonomik të mundshëm për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, dhe n.q.s nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga ish Administratorët e UK Kavajë SHA z. H. T. për periudhën 01.01.2018-1.08.2019, z. E. D. për periudhën 2.08.2019-13.08.2019, Administratori i UK Kavajë

SHA z. B. T. për periudhën 15.08.2019-31.12.2019, përgjegjësit e shpërndarjes së karburantit znj. R. B. për periudhën 11.03.2019-31.07.2019, Znj. F. Gj. për periudhën 21.07.2019- 31.08.2019, z. M. Sh. për periudhën 21.08.2019-31.12.2019 dhe z. N. C. me detyrë magazinier, për periudhën 1.01.2018-31.12.2019.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Kapak Pusetash” në sistemin elektronik në skedarin “Njoftimi i Fituesit” konstatohet se OE “A...” me ofertën më të ulët është publikuar fitues me datën 02.09.2019 ora 11:43 dhe OE në vendin e dytë është publikuar fitues me datën 02.09.2019, ora 13:11, pra nuk është pritur dy orë për të publikuar fitues OE të renditur në vendin e dytë. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesën e vetë AK në DST ku thuhet se OE i shpallur fitues duhet të konfirmojë pjesëmarrjen brenda dy orëve. Në dosje nuk gjenden dokumente që justifikojnë veprimin e mësipërm. Mosrespektimi i afatit të përcaktuar për të konfirmuar pjesëmarrjen nga OE i publikuar fitues “A...” ka sjellë që, diferenca midis ofertës së OE “A...” me vlerë 695,400 lekë (pa TVSH) dhe OE fitues “E.... P...” me vlerë 789,000 lekë (pa TVSH), konsiderohet dëm në buxhetin e shoqërisë UK Kavajë SHA, në vlerën 93,600 lekë (pa TVSH), dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit e prokurimit për blerje me vlerë të vogël znj. F. Gj., z. M. Sh. dhe z. E. S..

3.1 Rekomandimi: Nga Ujësllës Kanalizime Kavajë SHA, të ndiqen të gjitha hapat ligjore dhe administrative për arkëtimin e **vlerës 93,600 lekë (pa TVSH)** e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Ujësllës Kanalizime Kavajë SHA, dhe duhet të dëmshpërblehet nga anëtarët e komisionit e prokurimit për blerje me vlerë të vogël znj. F. Gj., z. M. Sh. dhe z. E. S..

Menjëherë

C/I. MASA PËR SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇIENCËS DHE EFEKTIVITETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2019, blerje me vlerë të vogël, u konstatua mungesa e plotësimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël. Mosplotësimi i kriterëve të veçanta në procedurat e prokurimit është si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Kompjuter dhe Printera”, konstatohet se likuidimi i mallit është bërë sipas faturës tatimore, Nr. 178, datë 04.03.2019, me vlerë 450,000 lekë (pa TVSH), për llogari të operatorit ekonomik fitues “F...”. Magazinimi i mallit ka fletë-hyrje Nr. 33, datë 04.03.2019. Gjithashtu, konstatohet se, në asnjë dokument të marrjes dhe të daljes nga magazina, nuk gjenden të shënuara numrat serial të pajisjeve të përfituara në këtë procedurë, kështu që gjurmimi i tyre bëhet i pa mundur, për rrjedhojë, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve, veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave, Nr. 30, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Referuar DST, në specifikimet teknike është kërkuar që për mallrat e prokuruar duhet të paraqitet garanci, me afat kohor minimumi 2 vjet, nga OE fitues. Në dosje, gjendet fleta e garancisë e lëshuar nga OE “F...”, datë 04.03.2019. Në fletë garanci nuk janë të shënuara Nr. serial i pajisjeve të përfituara nga kjo procedure, si dhe nuk janë përshkruar kushtet e garancisë në rast se do të nevojitet. Për sa më sipër, garancia e ofruar nuk mund të jetë me efikasitet të plotë, në rast të problemeve që mund të kenë pajisjet për periudhën 2 vjeçare. Mosplotësimi i kërkesave të mallit të prokuruar sipas specifikimeve teknike të DST, si edhe mungesa e numrave serial në

faturën tatimore dhe në garancinë e paraqitur, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, në vlerën 450,000 lekë.**

b. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Tuba Uji”, është kërkuar që mallrat duhet të shoqërohen me dokumentin teknik përkatës, ndër to edhe:

- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (B....., S....., BP, E....GmbH ose ekuivalent), e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike.
- Certifikata e testimit të tubave dhe pjesëve speciale nga prodhuesi. Ovaliteti i tubave nuk duhet të jetë më i madh se 1.5 %. Nga auditimi i dosjes konstatohet se të dy certifikatat e mësipërme mungojnë, kështu që OE “2.... T.... E....”, është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet **shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 695,000 lekë.**

c. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Rakorderi” është kërkuar që, mallrat të shoqërohen me dokumentacionin teknik përkatës:

- Certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i materialeve.
- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (B....., S....., B....., E.... GmbH ose ekuivalent) e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike të përshkruara. Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Rakorderi”, konstatohet se certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i materialeve mungon në dosje, dhe certifikata e origjinës së prodhimit të materialit PE, është në gjuhë të huaj, kështu që, OE “ T.... L....” është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST, që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet **shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 670,000 lekë.**

d. Në dokumentet e procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Tонера”, është kërkuar që: “Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor (në rastet kur kërkohet), dokumentet si më poshtë:

- Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2008/ISO 9001-2015.
- Certifikatë OHSAS -18001-2007(ose ekuivalente të vlefshme) për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në punë. Nga auditimi i dosjes, konstatohet se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret e mësipërme, kështu që OE “I.... O....”, është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST, që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 660,000 lekë.**

e. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Matës Uji”, kërkohen të plotësohen kriteret e më poshtme:

- Vërtetimin se OE i shpallur fitues, duhet të ketë shlyer të gjitha taksat (qendrore dhe vendore) Vërtetim nga OSHEE se objekti nuk ka detyrime të pashlyera.

Matësi i Ujit: (Të ofrojë mundësinë dhe të jete kompatibël me teknologjinë e Leximit Automatik të Matësi), Vulat: (Të kenë logon “Ujësjellës Kanalizime Kavajë”, 6 numra serial unik të njëpasnjëshëm në pjesën e përparme të trupit (pjesa femërore). Çelësat e bllokuesve: (Njeri krah i çelësit duhet të jetë i veshur me material plastik ose qeramike).Nga auditimi i dosjes, konstatohet se OE i shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e mësipërme, kështu që OE “A.... S....”, është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006,“Për prokurimin publik”,

i ndryshuar. Mosplotësimi i kërkesave të mallrave (matësa uji, vula dhe çelësive të bllokuesve) të prokuruar sipas specifikimeve teknike të DST, vlera e përfituar, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 750,000 lekë (pa TVSH).**

f. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Klor”, sipas kualifikimit përfundimtar, dokumentuar me procesverbalin Nr. 1 datë 25.07.2019 konstatohet se OE fitues “A....” renditet në vendin e 11 (njëmbëdhjetë). Shpallja fitues i OE “A....” është në kundërshtim me udhëzimin Nr. 3, datë 8.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, ku përcaktohet se: “Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të prokurimit vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e 10 (dhjetë) të klasifikimit”, i ndryshuar. Për sa më sipër kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Klor” vlera e përfituar nga OE “A....”, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 800,000 lekë (pa TVSH).**

g. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Kasete Matësash”, nga auditimi i sistemit elektronik të APP, në skedarin “Njoftimi i Fituesit”, OE “D... G...” është publikuar fitues në datë 01.07.2019, ora 09:47, sipas procesverbalit Nr. 1, datë 01.07.2019, i cili nuk ka konfirmuar pjesëmarrjen, kështu që është kaluar në OE të radhës, por konstatohet se, OE “A. C.” i renditur në vendin e dytë, është publikuar fitues në datë 01.07.2019, ora 10:09, kjo në kundërshtim me afatin e përcaktuar nga vetë AK në DST. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të konfirmojë pjesëmarrjen pranë autoritetit kontraktor brenda 2 orëve nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Gjithashtu, afati i publikimit midis vendit të tretë, të katërt dhe të pestë, si dhe vendit të gjashtë me të shtatë, nuk është respektuar nga AK. Në dosje nuk gjenden gjurmë që justifikojnë këto veprime të komisionit të vlerësimit. Mosrespektimi i afatit të përcaktuar për të konfirmuar pjesëmarrjen nga OE i publikuar fitues “D... G...” ka sjellë që, diferenca midis ofertës se OE “D... G...” me vlerë 468,000 lekë (pa TVSH) dhe OE fitues “A... C....” me vlerë 749,999 lekë (pa TVSH), **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 281,999 lekë.**

1.1 Rekomandimi: Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjellë si pasojë fitues një OE që ka patur mangësi në dokumentacion, që nuk është evidentuar nga ana e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt “Blerje Kompjuter dhe Printera”, AK ti kërkojë OE fitues “F....” të paraqesë një garanci, për mallrat e përfituara, ku të shënohet numri serial për çdo pajisje, gjithashtu kjo garanci të shoqërohet me kushtet e saj.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i proceseve gjyqësore rezulton se për periudhën objekt auditimi, konstatohet një numër i madh procedura gjyqësore e sekuestro konservative bankare të UKKA, si debitorë ndaj OSSHE, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Komisionerit për të drejtën e informimit, ERRU dhe punonjësve të larguar nga puna. Gjatë kësaj periudhe, janë larguar nga puna 210 punonjës (*duke përfshirë 79 punonjës së ristrukturimit të datë 02.08.2017*). Në UKKA SHA, nuk ka një dokumentacion të rregullt për numrin e saktë të procedurave gjyqësore për procedurat e zhvilluar/përfunduara dhe procedurat në proces (vlerën monetare të likuiduar për

secilën procedurë). Vendime e formës së prerë në proceset gjyqësore përgjatë vitit 2018 -2019 për të cilat kërkohet dëmshpërblim kanë **vlerë totale 10,892,567 lekë e cila përbënë efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë**. Për punonjësit është dhënë masa pushim nga puna si pasojë e thyerjes së disiplinës në punë, për mosparaqitje dhe shpërdorim detyre. Për vitin 2019 nga ana e UKK Sh.a Administratorit të saj janë kryer pushime kolektive nga puna në periudhën Shtator – Dhjetor 2019 ku janë larguar në total 96 veta dhe përkatësisht 21 në Shtator, 27 në Tetor, 22 në Nëntor dhe 26 në Dhjetor. Gjithashtu në vitin 2017 në periudhën Shtator-Nëntor 2017 janë larguar 81 veta nga puna. Nga verifikimi i procedurave për largim nga puna u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e parashikuara nga Kodi i Punës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” pika 3, neni 155 dhe neni 148.

2.1 Rekomandimi: Shoqëria dhe Drejtoria e Financës duhet të marrë masa për shqyrtimin e **efektit financiar** në vlerën totale **10,892,567 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqimit për shmangien e kostove shtese nga proceset gjyqësore në proces të cilat mbartin risk të lartë për efekt negative financiar në të ardhmen. Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dhënies së shpërblimeve rezulton se shoqëria edhe pse figuron me humbje gjatë vitit 2018 dhe 2019, përveç se ka punësuar persona mbi strukturë duke i shkaktuar dëme të mëtejshme shoqërisë gjithashtu ka shpërndarë edhe shpërblime për punonjës të saj. Shpërblimet për vitin 2018 kanë vlerë **efekti negativ financiar 130,000 lekë kurse për vitin 2019 kanë vlerë **efekti negativ financiar 806,088 lekë**. Në rast se shoqëria figuron me humbje nuk shpërndan shpërblim. Gjithashtu nuk ka shpërblim për punë jashtë orarit, siç është shpërblyer E. L. Puna jashtë orarit paguhet sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe pasqyrohet në pagën mujore të personit i cili ka punuar jashtë orari, në referencë të listë prezencës mujore. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Neni 6 Kompetencat e organeve kolegjiale 1. Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës; b) *masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor*, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.**

3.1 Rekomandimi: Këshilli i Administrimit dhe Titullari i shoqërisë UKKA SHA, të marrin masa që të rishqyrtojnë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2018 dhe 2019 në vlerën **936,088 lekë**, shpërblime të dhëna pas daljes së rezultatit financiar vjetor negativ, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën **efekt financiar negativ** për Buxhetin e shoqërisë dhe ka rënduar edhe më tepër kostot e shoqërisë në kushtet që ajo figuron me humbje që prej vitit 2015.

Menjëherë

C/II. DETYRIME NDAJ TË TRETËVE

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjobave dhe kamatëvonesat në sistemin tatimor si dhe gjobave kamatëvonesat mbi detyrimet e papaguara të energjisë elektrike rezulton se shoqëria UKKA SHA, nga mungesa e likuiditetit dhe keq menaxhimi aktualisht ka **gjoba dhe kamatëvonesa në shumën totale 96,096,211 lekë**. Nga auditimi i sistemit tatimor deri në Shkurt 2020, rezultojnë gjoba dhe kamatëvonesa në vlerën **8,637,236 lekë** si gjobë për pagesa të vonuara, nga të cilat 8,305,094 lekë janë gjoba për mos pagesa të TVSH në kohë reale, 270,850 lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, 40,000 lekë për tatim fitimin dhe 21,292 lekë për tatimin në burim vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar**. Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë detyrimet për TVSH, penalteti i së cilës rritet çdo ditë. Aktualisht interesat e regjistruara në sistemin tatimor janë në shifrën **3,787,461 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** ndër të cilat 3,719,389 janë interesat vetëm për mospagimin në kohë të detyrimit për TVSH dhe 68,072 lekë interesa për pagesa të vonuara të sigurimeve shoqërore dhe tatimit në burim. Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë faturat e energjisë elektrike me detyrim principal 173,708,004 lekë dhe gjoba e kamatëvonesa në shumën **83,671,514 lekë**, të cilat gjithashtu përbëjnë **efekt negativ financiar**. Penaltetet e mësipërme llogariten sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Sanksionet, Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit.

C.II Rekomandimi: Shoqëria, Këshilli i Administrimit dhe Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të kryejë në mënyrë më efçente menaxhimin e veprimtarisë së përditshme si dhe të shqyrtojë efektin negativ nga gjobat dhe kamatëvonesat në shumën **96,096,211 lekë**. Shoqëria UKKA SHA , të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve që ka mbi strukturë, të punësojë punonjës të kualifikuar, të konsiderojë ndryshimin e politikave tregtare dhe të menaxhojë me efektivitet asetet për rritjen e rentabilitetin të shoqërisë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Dhënie e masave disiplinore sipas rekomandimit të kategorisë *Masa Disiplinore* për personat të cilët aktualisht janë në marrëdhënie pune me Ujësjetllës Kanalizime SHA Kavajë, të cilët sipas të dhënave të raportuara nga ana e Ujësjetllës Kanalizime SHA Kavajë rezultojnë si më poshtë:

Nr.	Emri i Punonjësit	Pozicioni	Rekomanduar	Zbatuar
1	F. Gj.	Drejtores e Shitjes dhe Ish Drejtores Tregtare	“Vërejtje” deri në “Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës”	Larguar nga puna
2	M. Sh.	Kryeinxhinier	“Vërejtje” deri në “Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës”	Jo
3	N. C.	Magaziniere	“Vërejtje” deri në “Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës”	Jo
4	R. M.	Specialist	“Vërejtje”	Jo
5	G. Xh.	Drejtor Teknik	“Vërejtje”	Larguar nga puna
6	E. T.	Kryetar i Degës së Shitjes	“Vërejtje”	Larguar nga puna
7	A. Y.	Specialiste	“Vërejtje”	Larguar nga puna
8	J. Gj.	Laborante	“Vërejtje”	Larguar nga puna
9	E. S.	Specialist	“Vërejtje”	Jo
10	M. M.	Specialist	“Vërejtje”	Jo
11	E. Gj.	Specialiste	“Vërejtje”	Jo

12	S. K.	Specialist IT	“Vërejtje”	Larguar nga puna
13	Xh. A.	Kryetar i Degës Teknike	“Vërejtje”	Jo
14	B. X.	Përgjegjëse Finance	“Vërejtje”	Larguar nga puna
15	B. D.	Përgjegjës	“Vërejtje”	Larguar nga puna
16	E. S.	Specialiste	“Vërejtje”	Jo
17	R. V.	Specialist	“Vërejtje”	Larguar nga puna
18	R. V.	Specialist	“Vërejtje”	Larguar nga puna
19	G. Xh.	Drejtor Teknik	“Vërejtje”	Larguar nga puna
20	I. K.	Përgjegjës i Impiantit	“Vërejtje”	Larguar nga puna
21	S. P.	Përgjegjës i Impiantit	“Vërejtje”	Larguar nga puna
22	F. Gj.	Përgjegjës i Impiantit	“Vërejtje”	Larguar nga puna
23	A. D.	Përgjegjës i Impiantit	“Vërejtje”	Jo
24	I. K.	Përgjegjës i Impiantit	“Vërejtje”	Jo
25	J. Gj.	Laborante	“Vërejtje”	Larguar nga puna

II. PORTI DETAR SHA VLORË:

Konkluzioni i auditimit: Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe manualit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Portin Detar SHA

Vlorë për periudhën 01.11.2017 deri me 31.12.2019 dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, rezultoi se:

Niveli (në numër) i pranueshmërisë së rekomandimeve është në masën 86.7 %. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar (në numër), plotësisht, pjesërisht dhe proces zbatimi është 90.38 %.

E shprehur në vlerë, nga vlera e rekomanduar prej 80,094,988 lekë janë pranuar nga subjekti vlera 48,087,314 lekë, ose 60 %. E shprehur në vlerë, nga shuma e pranuar 48,087,314 lekë, janë zbatuar plotësisht, pjesërisht apo janë në proces rekomandime në shumën 10,921,414 lekë, ose 22.7 %.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 86.7 % si numër total rekomandimesh dhe 22.7 % në vlerë, çka tregon se nga Porti Detar SHA Vlorë është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve por ky subjekt duhet të përqendrohet kryesisht në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara dhe ndjekjen e tyre përmes proceseve gjyqësore, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërkitimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me pagesat e kryera në mënyrë të parregullt. Konkretisht nga auditimi rezultoi si vijon:

- **34 masa me karakter organizativ**, të pranuar nga subjekti në sasinë 28 masa, ose 82.3 %, nga të cilat 19 masa të zbatuara, 5 masa të zbatuara pjesërisht dhe 4 masa të pazbatuara;

- **5 masa shpërblim dëmi** me vlerë **3,935,277 lekë**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat janë zbatuar 2, ose 40 %, në vlerën 133,333 lekë, ose 3.4 %, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, ose 40 %, me vlerë 3,774,344 lekë, ose 95.9 % dhe është në proces 1 masë, ose 20 % me vlerë 27,600 lekë, ose 0.7 % ;

- **4 masa për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike** me vlerë **6,086,137 lekë**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat janë zbatuar 3, ose 75 %, në vlerën 5,273,182 lekë, ose 86.6 % dhe është në proces 1 masë, ose 25 % me vlerë 812,955 lekë, ose 13.4 % ;

- **1 masë për të ardhura të munguara** me vlerë **900,000 lekë**, e pranuar nga subjekti dhe e zbatuar;

- **1 masë për pagesat e kryera në mënyrë jo të rregullt** me vlerë **37,165,900 lekë**, e pranuar nga subjekti por e pa zbatuar;

- **1 masë në drejtim të shmangies së paligjshmërisë në procedurat e prokurimit** me vlerë **32,165,674 lekë**, e papranuar nga subjekti;

- **9 masa disiplinore**, nga të cilat pranuar dhe zbatuar 8 masa;

- **5 masa administrative**, pranuar nga subjekti 5 masa, nga të cilat janë zbatuar 3 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa;

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Porti Detar SHA Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 974/8 prot., datë 18.05.2020, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është e pazbatuar ose e zbatuar pjesërisht. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore për masat e pazbatuara, të zbatuara pjesërisht apo në proces, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se nga subjekti “Porti Detar”, Vlorë sha nuk janë pranuar 3 rekomandime, janë pranuar por nuk janë zbatuar 2 si dhe janë zbatuar por pjesërisht 5 rekomandime në kundërshtim me nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të shtetit. Konkretisht si në tabelën e më poshtme:

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të pa pranuar	Realizuar	Realizuar pjesërisht	Në proces	Të pa zbatuara
Përmirësime ligjore	-	-	-	-	-	-	-
Masa organizative	17	17	-	8	5	3	1
Masa shpërblim dëmi	6	5	1	3	-	2	1
M.D.ekonomik pamundësi arkëtimi	1	1	-	-	-	-	1
Masa për elimin.....	4	2	2	1	-	1	2
Masa disiplinore	12	12	-	12	-	-	-
Totali	40	37	3	24	5	6	4
Totali në %		93%	8%	60%	13%	15%	10%

Në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Porti Detar Vlorë janë pranuar 37 nga 40 rekomandime. Nga këto, 5 janë zbatuar pjesërisht duke mos përmirësuar plotësisht proceset e punës dhe për 1 rekomandim nuk është marrë ende asnjë masë për tu zbatuar.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht, që nuk janë pranuar si dhe ato që janë pranuar dhe nuk janë zbatuar ende.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borderosë së pagave për vitet 2018-2019 u konstatua se paga bazë mbi të cilën llogariteshin sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimet nuk përfshinte shtesën për vjetërsinë e punës 1-2% në vit referuar kontratës kolektive të punës dhe niveli të pagave të miratuar në Programin Ekonomik 2018 dhe 2019. Nga zyra e financës nuk është llogaritur dhe nuk është paguar shtesa për vjetërsi në punë konkretisht në vlerën 111,600 lekë në total për vitin 2018 dhe në vlerën 199,440 lekë në total për vitin 2019.

-Në kontratat individuale të punës të hartuara nga zyra e Burimeve Njerëzore nuk specifikohet paga e punonjësve në kundërshtim me Kontratën Kolektive dhe Kodin e Punës. Për sa kohë që përcaktimi i pagës për çdo punonjës bëhet referuar pozicionit të punës, kualifikimit të diplomës dhe vjetërsisë në punë, paga duhet të specifikohet në çdo kontratë individuale dhe jo vetëm në shkresat e emërimit.

-Nga auditimi i strukturës së miratuara si dhe rregullores së miratuar me vendimin Nr. 3 datë 19.03.2019 të Këshillit Mbikëqyrës u konstatua se në disa pozicione të strukturës organizative nuk është përcaktuar niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet për pozicionin si dhe në rregullore nuk janë përcaktuar kriteret bazë për çdo pozicion. Nisur nga fakti se pjesë përbërëse e pagës bazë është “paga e grupit” e cila jepet në formë shpërblimi për nivelin e diplomës përcaktimi i kriterëve arsimore dhe profesionale për secilin pozicion përbën domosdoshmëri. Gjithashtu nga auditimi i procedurave: të rekrutimit, lëvizjet paralele dhe ngritja në detyrë të punonjësve u konstatua se, nuk janë parashikuar procedura rekrutimi në rregulloren e shoqërisë si dhe nuk zbatohet asnjë procedurë përzgjedhjeje. Rekrutimi dhe lëvizjet brenda shoqërisë bëhen vetëm me shkresa emërimi nga Administratori i shoqërisë.

2.1 Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë Porti Detar SHA Vlorë, të kriterëve të përshtatshme për çdo pozicion pune, si dhe publikimin e vendeve vakante dhe ndjekjen e procedurave për një proces cilësor dhe të drejtë të rekrutimit dhe zhvillimit profesional të punonjësve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në shkresat e Asamblesë Aksionare për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është pasqyruar tabela përmbledhëse e shpenzimeve të miratuara për programin ekonomik përkatës ku përcaktohet numri i punonjësve, paga mesatare dhe fondi i pagave. Nga auditimi u konstatua se në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Programet Ekonomik të viti 2017 numri total i punonjësve është 120, për vitin 2018 numri total i punonjësve është 121 dhe për vitin 2019 numri total i punonjësve të miratuar është 121. Ndërkohë referuar Programit Ekonomik analitik për të tre vitet nga Shoqëria janë punësuar dhe 15 punonjës “Ngarkim-shkarkimi” si punonjës me kohë të pjesshme duke e çuar numrin e punonjësve në total për vitin 2017 në 135 dhe për vitin 2018 dhe 2019 në 136. Gjithashtu, në tabelën përmbledhëse të miratuar nga Asambleja aksionare në zërin “Fondi i pagave” për vitin 2017, 2018 dhe 2019 përfshihen vetëm shpenzimet “Paga bruto” për punonjësit me kohë të plotë dhe jo për punonjësit me kontratë të cilët referuar kodit të punës duhet të trajtohen njësoj si punonjësit me kohë të plotë dhe shpenzimet për punonjësit me kohë të pjesshme duhet të jenë pjesë e “fondit të pagave” për shoqërinë. Nisur nga sa më sipër konstatohet se MFE dhe Ministria e linjës edhe pse janë shprehur parimisht dakord me përmbajtjen e Programit ekonomik për vitet 2017, 2018 dhe 2019 në tabelat përmbledhëse të miratuara nga Asambleja Aksionare nuk kanë përfshirë punonjësit me kontratë për të cilët shpenzimet e pagave janë respektivisht 3,744,000 lekë për vitin 2018 dhe 4,056,000 lekë për vitin 2019 ose 7,800,000 lekë në total. Nga ana e shoqërisë nuk janë përfshirë në programin ekonomik shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve me kohë të pjesshme për të bërë të mundur trajtimin financiar në përputhje me kontratat përkatëse dhe në respektim të të drejtave të përcaktuara në Kodin e Punës me qëllim shmangien e diskriminimit dhe trajtimin e barabartë të punonjësve.

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Portit Detar Vlorë SHA të marrin masa për përfshirjen në planifikim dhe miratim të programit ekonomik-financiar të zërit “fondi i pagave” edhe shpenzimet për punonjësit me kohë të pjesshme, me qëllim trajtimin e plotë financiar të tyre ku të përfshihet jo vetëm paga bruto, por edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, me qëllim për të dhënë sigurinë e trajtimit të barabartë të punonjësve. Gjithashtu organet drejtuese të shoqërisë në vijimësi të marrin masa për të bërë të mundur përfshirjen e punonjësve me kohë të pjesshme në organikën e shoqërisë dhe trajtimin e tyre si punonjës jo me kohë të pjesshme.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në raportin e auditimit për vitin 2018, audituesit e pasqyrave financiare kanë dhënë Opinion me rezervë. Por nga auditimi i këtij raporti dhe letrës drejtuar drejtimin të shoqërisë, konstatohet se opinionin e auditimit në pasqyrat financiare, nuk është pasqyruar qartë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) 250 “Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare”. Kjo konstatohet dhe nga fakti se ky raport është ridorëzuar për herë të dytë pasi, Asambleja Aksionare ka konstatuar problematika në raportin e auditimit, duke kërkuar riformulimin e opinionit e audituesve të pavarur. Në pasqyrat e vitit 2018, zëri Mallra për rishitje paraqiten në vlerën 8,264,765. Kjo gjendje vazhdon që prej vitit 2017 e pandryshuar edhe pse gjatë vitit 2017 kanë dal materiale jashtë përdorimit në vlerën 65,702 lekë, nuk janë pasqyruar në kontabilitet si shitje në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet kombëtare të kontabilitetit.

4.1 Rekomandimi: Përgjegjësi i Zyrës së Financës të marrë masa për llogaritjen dhe pasqyrimin e ndryshimeve në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare pas daljes jashtë përdorimit të zërit Mallra për rishitje.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Administratori dhe sektori i financës në përgatitjen e pasqyrave financiare, kanë përdorur norma për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale, specifike të veprimtarisë portuale, të pa vlerësuar dhe aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 5, 9, “Mbajtja e kontabilitetit”, ku citohet se “Të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; “Respektimi i standardeve kontabël”,1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësisë ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël” dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1, pika 103, ku citohet se: Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike,...” dhe Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, pika 39 citon se “Çdo njësi ekonomike cakton metodat e amortizimit dhe normat e amortizimit në politikat dhe procedurat e saj kontabël, të cilat duhet të përdoren për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale”.

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtimi i shoqërisë të merren masa për aprovimin e normave, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale, nga specialistët e fushës dhe brenda limiteve ligjore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Lidhur me ekzistencën dhe lëvizjen e aktiveve të qëndrueshme kemi konstatuar se për vitet 2017 dhe 2018 Shoqëria nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo që ka në administrim, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Për vitin 2019 regjistri kontabël nuk është mbajtur sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Pikat 26 deri në 33.

6.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, të marrë masa nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Shoqërisë, për të bërë të mundur sa më parë hartimin e regjistrave kontabël të aktiveve, të cilat të jenë sipas formateve të kërkuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga shoqëria Porti Detar Vlorë nuk është zbatuar Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe nuk është implementuar në Rregulloren e Brendshme të saj. Ligji nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Për periudhën nga data 06.09.2017 deri më 13.12.2018 Administratori në cilësinë e Titullarit të Shoqërisë nuk ka emëruar nëpunësin zbatues;
- Nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit;
- Nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;
- Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari i shoqërisë, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre;
- Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;
- Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave;
- Nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura;
- Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtarisë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to;
- Nuk ka procedura të përcaktuara të brendshme anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive;
- Nuk është hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Deklarata dhe Raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pyetësonin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për organizimin dhe funksionin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*”, i ndryshuar Neni 8 pika b germa a, neni 12 pika 1, neni 15, neni 16 pika 2 pika 3, neni 17 pika 1, neni 18 pika 1, neni 20 pika 2 germa a, neni 21 pika 2, neni 27 pika 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Pika 2.2.8, pika 2.5.1, pika 3.1, pika 3.2 pika 4.2.8 sipas Kapitujve II, III, IV dhe Kapitulli V, Shtojca nr. 2 si dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011 “*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike*” pika 15.

7.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masat e menjëhershme në drejtim të implementimit në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të miratohen rregullat e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe vënien e administratorit të shoqërisë dhe drejtuesve të tjerë kundrejt përgjegjësisë dhe detyrimit të marrjes së masave për implementimin e ligjit dhe njëkohësisht ndërgjegjësimin e të gjithë punonjësve për zbatimin e kërkesave të këtij Ligji, sa më sipër cituam dhe akteve të dala në funksion të tij. Nga administratori në cilësinë e Titullarit të Shoqërisë të merren masa për trajnimin e të gjithë stafit të shoqërisë në lidhje me kërkesat e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vënien në efikasitet të sistemit të kontrollit të brendshëm.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se:

- Nuk janë kryer përditshme për ndryshimet e kryera në rregulloret e brendshme mbi pozicionin e sekretar-arkivit si dhe nuk është përcaktuar sipas dispozitave ligjore kompetenca lidhur me mirëmbajtjen, ruajtjen, administrimin e vulës së Shoqërisë;

- Nga Zyra e Shërbimeve të Brendshme, sektor i cili mbulon arkivin, nuk është kryer kontrolli fizik i dokumentacionit arkivor të shoqërisë gjë e cila duhet të kryej çdo 6 muaj duke mbajtur procesverbalet përkatëse;

- Nga verifikimi i dosjeve të arkivit të Shoqërisë është konstatuar se janë evidentuar dokumentacione që kanë tejkaluar afatin kohor, të cilat duhen dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;

- Për periudhën objekt auditimi nuk është kryer mbyllja e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese brenda afateve të përcaktuara në ligj, mbi verifikimin e dokumenteve dhe saktësinë e afateve të ruajtjes. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 4, neni 5 pika 6, neni 8, neni 25, neni 43, pika a, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 43 si dhe Rregulloret e Brendshme të Shoqërisë miratuar respektivisht me Vendimin nr. 7, datë 04.04.2017 dhe Vendimin nr. 3, datë 19.03.2019.

8.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Shërbimeve të Brendshme, të marrë masa për kryerjen e përditësimeve në rregulloren e brendshme për përcaktimin e kompetencave mbi mirëmbajtjen, ruajtjen administrimin e vulës së shoqërisë, dorëzimin e dokumentacionit i cili ka tejkaluar afatin kohor në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, kontrollin fizik të dokumentacionit arkivor si dhe mbylljen e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese brenda afateve të përcaktuara në ligj.

9. Gjetje nga auditimi: Prej tetorit të vitit 2019 në Terminalin e ri ushtrojnë aktivitetin e tyre me qira 6 subjekte. Nga auditimi u konstatua se këto subjekte nuk shlyejnë detyrimet e energjisë elektrike pasi furnizohen nga sistemi qendror i terminalit dhe nuk kanë matës të instaluar në secilin subjekt për llogaritjen e shpenzimeve të energjisë elektrike. Konsumi i energjisë për këto subjekte për periudhën objekt auditimi është paguar nga Portit Detar Vlorë sha dhe jo nga subjektet me qira në kundërshtim me nenin 2 të Kontratës së qirasë.

9.1 Rekomandimi: Nga drejtoria e Portit Detar SHA Vlorë të merren masa për llogaritjen dhe mbajtjen e vlerës së shpenzimeve për energji elektrike nga subjektet me qira brenda terminalit për periudhën tetor-dhjetor 2019. Si dhe të instalohen matës të veçantë në çdo subjekt për përcaktimin e saktë të konsumit të energjisë elektrike në muajt në vazhdim.

B/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratën me objekt “Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”, për të cilën është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. A. M. dhe sipërmarrësit të punimeve “J....” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. D. M. me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. A.

M. dhe sipërmarrësit të punimeve “J...” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. D. M. me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh rezultoi se janë likuiduar zëra punimesh të pakryera në fakt dhe/apo zëra punimesh jo në përputhje me ato të pasqyruara në situacion. Konkretisht nga krahasimi i librezës së masave, situacionet përfundimtar si dhe verifikimit të kryer rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo në përputhje me zërin e përshkruar në situacion në shumën **1,367,832 lekë pa TVSh**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimi Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3, VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. nr. 07 prot., datë 06.01.2017, kontratën e shërbimit të kolaudimit të lidhur sipas aktit me nr. 785 prot., datë 28.12.2016 si dhe Urdhrin e Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës së zbatimit të punimeve.

1.1 Rekomandimi Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **1,367,832 lekë pa TVSh** nga ana e OE “J...” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën bazë të lidhur sipas aktit me nr. 776 prot., datë 23.12.2016, me amendimet përkatëse si dhe kontratën shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018, mes tij dhe AK Port Detar Vlorë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kontratën me objekt “Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”, për të cilën është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. A. M. dhe sipërmarrësit të punimeve “J...” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. D. M. me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. A. M. dhe sipërmarrësit të punimeve “J...” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. D. M. me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh rezultoi se në preventiv ofertën e hartuar nga ana e sipërmarrësit të punimeve në ofertën e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor janë paraqitur analiza kostoje duke konsideruar si punime ndërtimi edhe punimet për vendosjen e pajisjeve. Në fakt një metodë e tillë e përllogaritjes së kostos është e gabuar pasi:

a. Furnizimi dhe vendosja e pajisjeve si UPS 20 UPS 20 kVA ,3f. 230V, 5 min i pavarur i montuar ne RAK, RACK lokal 12U, i montuar në mur me panel 24 portash, Switch 24 porta+ I fibër optike, Central alarm zjarri max 125 detektorë , Skaner me rreze X për bagazhet , Amplifikator 2x500 w. Mikrofon, Bokse në tavan etj. *nuk janë punime ndërtimi dhe si të tilla nuk mund ti nënshtrohen kësaj mënyrë të përllogaritjes së kostos;*

b. Vlera e blerjes së të gjitha pajisjeve *nuk mund të përfshihet as tek shpenzimet e drejtpërdrejta dhe as tek shpenzimet e përgjithshme dhe si e tillë, vlerës së furnizimit me pajisje nuk mund ti shtohet vlera prej 8 % si shpenzim i përgjithshëm dhe as ajo prej 10 % si fitim për sipërmarrësin pasi nuk është as punim ndërtimi dhe as punim teknologjik por është punim montimi;*

Duke qenë se punimet e montimit, nuk janë punime ndërtimi të kategorisë *Punime ndërtimi* rezultojnë se edhe analiza e kostos së hartuar nga ana e sipërmarrësit është kryer në kundërshtim me analizën e miratuar të strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të përfitohen tepër shuma prej **2,406,512 lekë pa TVSh**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3, Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003, në Kreun I, germa A PUNIME NDËRTIMIT, paragrafi i fundit, Kreu I, germa B Punime Teknologjike dhe të Montimit, Kreu II, Pika B Shpenzimet e Përgjithshme dhe Fitimi, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. nr. 07 prot., datë 06.01.2017 si dhe Urdhrin e Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës së zbatimit të punimeve.

2.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë SHA të marrë masat për kontabilizimin dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit për shlyerjen e dëmit ekonomik në shumën **2,406,512 lekë pa TVSh** nga ana e OE “J...” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën bazë të lidhur sipas aktit me nr. 776 prot., datë 23.12.2016, me amendimet përkatëse si dhe kontratën shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018, mes tij dhe AK Port Detar Vlorë.

Menjëherë

B/II. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në kartelat përkatëse të mjeteve, në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre. Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave të dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultojnë se, janë tërhequr me tepër 4927 litra naftë në vlerën 812,955 lekë, të cilat nuk janë të plotësuara me dokumentacion. Sasia e tërhequr e karburantit ose vlera **812,955 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë** nuk përputhet me kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Administratori në cilësinë e Titullarit dhe nëpunësit autorizues, Shefi i Zyrës së Administrimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe Dega Teknike dhe Investimeve, e caktuar për menaxhimin e aktiveve konstatohet se, nuk kanë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë dhe nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar si dhe pika 5, pika 10, pika 19, pika 35 germa a, b, c, pika 36, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Porti Detar Vlorë, Zyra e Administrimit Financiar, Dega Teknike dhe Investimeve, të marrë masat për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të tij. Nga Dega Teknike dhe Investimeve, në kartelat përkatëse të automjeteve të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat si dhe të kryhet ky riparimi në automjetet në të cilat janë konstatuar defekte në aparatit e kilometrazhit.

Menjëherë

C. PAGESA TË KRYRA NË MËNYRË JO TË RREGULLT

(për punime të pakryera në momentin e likuidimit)

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA”, është lidhur kontrata bazë me nr. 776 prot., datë 23.12.2016 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. A. M. dhe sipërmarrësit të punimeve “J...” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. D. M. me vlerë të kontratës 212,638,360 lekë pa TVSh ose 249,186,632 lekë me TVSh si dhe kontrata shtesë me nr. 520/3 prot., datë 26.10.2018 mes AK Porti Detar Vlorë SHA, e përfaqësuar nga Titullari z. A. M. dhe sipërmarrësit të punimeve “J...” ShPK, e përfaqësuar nga administratori z. D. M. me vlerë të kontratës 19,627,350 lekë pa TVSh ose 23,082,812 lekë me TVSh. Duke qenë se në auditimin e mëparshëm, zbatimi i kësaj kontrate është audituar për pjesën progresive deri në fund të periudhës objekt auditimi (deri më 31.10.2017) pasi ka rezultuar në proces, në vijim paraqiten konstatimet vetëm për periudhën objekt auditimi. Konkretisht rezultoi se janë situacionuar nga sipërmarrësi punime të pakryera në fakt në momentin e situacionimit në shumën 44,214,972 lekë pa TVSh. Nga këto rezulton e likuiduar për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit shuma **37,165,900 lekë pa TVSh**. Situacionimi dhe likuidimi i punimeve të pakryera në fakt në momentin e likuidimit të tyre, përbën një veprimtari krejtësisht fiktive dhe është fenomen diskriminues për OE të tjerë, për sa kohë pagesa të tilla nuk janë parashikuar në formë të rregullt ligjore si parapagime në Dokumentet Standarde të Tenderit. Gjithashtu, veprime të tilla fiktive denatyrojnë krejtësisht procesin e prokurimit pasi vetë AK, në zbatim të LPP dhe RrPP vendos kriter në lidhje me kapacitetet teknike dhe ekonomike që duhet të kenë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit kur në fakt, siç edhe është shprehur më sipër, një pjesë e pagesave pjesore kryen për punime të situacionuara por të pakryera ende në fakt. Kjo praktikë pagese është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm, ku pagesat për këtë kontratë kanë qenë në fillim të punimeve, por që me këtë formë pagese ka vijuar deri në përfundim të saj. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 1, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 07 prot., datë 06.01.2017 si dhe Urdhri i Titullarit nr. 101 datë 20.03.2018 për monitorimin e zbatimit të kontratës.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Portit Detar Vlorë SHA të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësisë në lidhje me pagesën e kryer për punime të situacionuara e të likuiduara dhe njëkohësisht të pakryera në fakt në momentin e likuidimit. Gjithashtu, të rrisë efektivitetin e monitorimit të kontratave me qëllim shmangien e pagesave për punime të tilla.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/1. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT).

- Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Portit Detar Vlorë SHA, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë**:

1. Subjektit “**I... D...**” **ShPK** me përfaqësues ligjor I. D., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1.../6... në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve;
 2. Subjektit “**G... C...**” me përfaqësuese ligjore D. P., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1.../1... datë 23.03.2018 në cilësinë e kolaudatorit të punimeve;
- për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të investimit me objekti “**Zgjerimi i Terminalit të Portit Detar Vlorë SHA**”.

II. REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 2 SHA TIRANË:

Konkluzioni i auditimit: Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe manualit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Rezidencën Studentore Universitare nr. 2 SHA Tiranë për periudhën 01.07.2017 deri me 31.12.2019 dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, rezultoi se:

Niveli (në numër) i pranueshmërisë së rekomandimeve është në masën 100 %. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar (në numër), plotësisht, pjesërisht dhe proces zbatimi është 98.6 %.

E shprehur në vlerë, nga shuma e rekomanduar prej 728,290,207 lekë janë pranuar nga subjekti vlera 728,290,207 lekë, ose 100 %. Nga këto, janë zbatuar plotësisht, pjesërisht apo janë në proces rekomandime në shumën 728,290,207 lekë, ose 100 %.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 98.6 % si numër total rekomandimesh dhe 100 % në vlerë, çka tregon se nga Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 SHA Tiranë është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve por gjithsesi ky subjekt nuk ka mundësuar ndjekjen e procedurave të duhura duke ndërprerë përpjekjet e tij për kryerjen e ndalesave, konkretisht, padive gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara. Për rrjedhojë Rezidenca Studentore nr. 2 SHA duhet të përqendrohet kryesisht në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara dhe ndjekjen e tyre përmes proceseve gjyqësore, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht si dhe ndjekjen e atyre në proces. Konkretisht duhen marrë masa për të zbatuar si vijon:

- **47 masa me karakter organizativ**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat 32 masa të zbatuara, 4 masa të zbatuara pjesërisht, 10 masa në proces dhe 1 masë të pazbatuar;

- **2 masa shpërblim dëmi** me vlerë **1,194,480 lekë**, të pranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat zbatuar pjesërisht 1 masë, në vlerën 1,105,840 lekë, ose 92.6 % dhe është në proces 1 masë, me vlerë 88,640 lekë, ose 7.4 % ;

- **4 masa për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike** me vlerë **76,642,590 lekë**, të pranuar dhe të zbatuara nga subjekti në masën 100 %;

- **5 masë në drejtim të shmangies së paligjshmërisë në procedurat e prokurimit** me vlerë **650,453,137 lekë**, të papranuar nga subjekti në masën 100 %, nga të cilat zbatuar 3 masa në vlerën 13,191,132 lekë, ose 2 %, zbatuar pjesërisht 1 masë në vlerën 3,955,480 lekë, ose 0.6 % dhe në proces zbatimi 1 masë në vlerën 633,306,165 lekë, ose 97.4 %.

- **15 masa disiplinore**, , nga të cilat pranuar dhe zbatuar në masën 100 %;

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 SHA Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj me nr. 972/11 prot., datë 28.05.2020, konstatohet se është vlerësuar procesi i zbatimit të rekomandimeve por gjithsesi ky subjekt nuk ka mundësuar ndjekjen e procedurave të duhura duke ndërprerë përpjekjet e tij për kryerjen e ndalesave, konkretisht, padive gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore për masat e pazbatuara, të zbatuara pjesërisht apo në proces, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezultoi se:

-Në lidhje me respektimin e afatit 20 ditor dhe 6-mujor për informimin dhe raportimin e KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve rezultoi se ky afat është zbatuar dhe KLSH është informuar respektivisht me shkresën nr. 485/1 datë 07.12.2017 për planin e masave mbi rekomandimet dhe me shkresën nr. 515 datë 07.05.2018 raport mbi zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH. Për zbatimin e masave rezultoi se; nga 35 masa të rekomanduara gjithsej me shkresën nr. Nr. 770/10 Prot., datë 22.11.2017 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi Nr. 159, datë 22.11.2017, të Kryetarit të KLSH-së, janë marrë në konsideratë dhe realizuar plotësisht 23 masa, janë realizuar pjesërisht 7 masa, janë në proces 4 masa dhe nuk është realizuar 1 masë, veprim në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c.

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Rezidenca Studentore Nr. 2, Tiranë, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë ka marrë 46 vendime nga të cilat 8 vendime janë marrë pa u votuar në mbledhjet ku janë njoftuar për diskutim, në mospërputhje me Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, neni 14/1.

Janë marrë 11 vendime tej kompetencave të KM, pasi për të gjithë këto vendime duhet të shprehet Titullari i njësisë AP, që sipas rastit është Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak. Janë marrë 2 vendime pas përfundimit të mandatit të KM. Gjithashtu rezultoi se 14 vendime janë marrë pa u zhvilluar mbledhje, në kundërshtim me ligjin 8480, neni 14 dhe ligji nr. 44/2015, neni 98/5. Pra në total janë marrë 17 vendime nga 46, ose 37% e vendimeve të KM në mospërputhje ligjore. Përveç sa më sipër vendimet krijojnë mospërputhje ligjore me ligjin nr. 9901, neni 163, “Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia”. KM nuk ka raportuar në Ministrinë e linjës në çdo 3 muaj, si edhe ka marrë dhe analizuar raportet e ecurisë nga Administratori i shoqërisë, në çdo tre muaj. Marrja, analizimi dhe raportimi i këtij informacioni nuk është bërë në asnjë mbledhje, në mospërputhje me VKM nr. 642, datë 11.10.2005, i ndryshuar. KM nuk ka rregullore ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e KM ndaj RSU nr. 2 SHA, në mospërputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, neni 161/1. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë nuk ka mbajtur procesverbale për secilën mbledhje gjatë gjithë veprimtarinë e vet, në mospërputhje me ligjin nr. 44/2015, neni 98/5. Nuk është bërë protokollimi i procesverbaleve të mbledhjeve, në mospërputhje me Udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), neni 18. Në procesverbal në asnjë rast nuk evidentohet shkresa që ka iniciuar vendimmarrjen, ku mungojnë të shpjegohet numër protokollit, datë dhe personi që ka kërkuar/propozuar vendimmarrjen e KM të shoqërisë, në mospërputhje me Udhëzimin e DPA, neni 13. Ka mbledhje të KM për të cilat sipas procesverbalit të mbledhjes nuk ka diskutime për çështje të caktuara, por KM ka dalë me vendim. Ka vendime pa një protokoll mbledhje në mospërputhje me ligjin nr. 44/2015, neni 98/5. Në periudhën audituese ka mungesa për: disa anëtarë të KM nuk kanë bërë deklaratimet për pjesëmarrjen apo jo në një këshill të dytë mbikëqyrës, në mospërputhje me VKM nr. 642, datë 11.10.2005, pika 6/c. Jo të gjithë anëtarët e KM nuk kanë plotësuar deklaratën e Konfliktit të Interesit, sipas VKM nr. 642, pika 5 dhe Ligjit nr. 9901, neni 13/1, neni 156/5 si edhe nuk kanë paraqitur Dëshmi Penaliteti. Nuk rezultoi të jetë bërë asnjë raportim 3 mujor në KM nga ana e Administratorit të RSU Nr. 2 SHA, Tiranë.

2.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për hartimin e një rregullore të procedurës së funksionimit të këshillit e zbatimit të kuadrit rregullator, përmes marrjes së raportimit nga Administratorët, gjithashtu të merren masat për raportimet periodike në AP dhe Ministrinë e Linjës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Drejtori i RSU Nr. 2 (ish NTS nr. 2), me shkresën prot. nr. 990, datë 14.04.2011 i ka kërkuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) regjistrimin e sipërfaqes prej 16,015 m² në zërin troje, shkresë e administruar aktualisht në dosjen e gjykatës, për një nga godinat në proces gjyqësor. Shoqëria ndër vite duke përfshirë edhe periudhën audituese, nuk disponon inventar fizik për sipërfaqet troje, por vetëm vlerë e cila nuk përkon me vlerat në VKM nr. 89, datë 03.02.2016, Zona kadastrale 8120 Tiranë, si dhe nuk ka ndërmarr asnjë masë për të kërkuar informacion në Agjencinë Shtetërore e Kadastrës, për origjinën e pronës për të dhëna në sistemin elektronik IPS, me qëllim marrjen e titujve të pronësisë. Për këtë situatë të trashëguar ndër vite mbajnë përgjegjësi organet drejtuese të shoqërisë. RSU nr. 2 në korrespondencat e vitit 2018 me ZVRPP, **përfshirë kërkesat në gjykatë, ku kërkon njohjen e 13,469 m² sipërfaqe troje, ose 2,546 m² më pak, pa u shprehur pse kjo mungesë.** Në lidhje me këtë situatë për arsye të proceseve gjyqësore grupi i auditimi nuk mund të dilte me një opinion të vetin për këtë çështje.

3.1. Rekomandimi: Administratori i RSU nr. 2 të marrë masa për ndjekjen administrative dhe ligjore të evidentimit të sipërfaqes prej 2,546 m² troje, si edhe regjistrimit të saj në ZVRPP.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Shoqëria NTS nr. 2 (sot RSU nr. 2 ka një marrëveshje noteriale me Rep. Nr. 119 dhe Kol. Nr. 51, datë 10.01.2018 me shoqërinë “A. N. SHPK” në cilësinë e sipërmarrësit për investim, për dhënien e një pasurie truall prej 110 m², brenda së cilës ndodhet një ndërtesë prej 84 m² ndërtim i cili është oxhak, ku për këtë pasuri RSU do të merrte një ambient mensë me sipërfaqe total prej 70 m², përfshirë saj janë edhe sipërfaqet funksionale. Këto veprime janë në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, neni 9/1/2/c. Sipas kërkesave të mëhershme në ZVRPP për pasurinë 10/212, është kërkuar të hipotekohen 161 m² truall dhe 84 m² ndërtesë. Shoqëria RSU nr. 2, sipas kërkesës së investitorit, ka revokuar kontratën noteriale sipërcituar, njëkohësisht i ka kërkuar KM të shoqërisë të shprehet me vendim. KM i shoqërisë me Vendimin nr. 88, datë 17.10.2018 pa u zhvilluar mbledhje, ka pranuar këtë kontratë bashkëpunimi në mospërputhje me ligjin nr. 44/2015, neni 98/5 dhe ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar, neni 163/4/d. Nuk është njoftuar Këshilli Bashkiak Tiranë në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, neni 9/1/2/c dhe neni 54/e. Administratori i RSU nr. 2 në datë 07.11.2018 ka lidhur kontratën noteriale Rep. nr. 5453, Kol. nr. 2330, mes RSU nr. 2 dhe OE me të njëjta kushte si kontrata e fillestare, bashkëlidhur të cilës jepet informacion se një person privat që dispononte një sipërfaqe ndërtim do të marrë një pronë në sipërfaqe proporcionale, kjo klauzolë për ndërtesën 84 m² nuk ofrohet nga ndërtuesi. Kontrata noteriale është në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, neni 9/1/2/c dhe nenin nr. 54/e. Më vonë në datën 27.03.2019 ka pasur një aneks kontrate me Rep. Nr. 1718, Kol. Nr. 728 mes RSU nr. 2 dhe investitorit, bashkëlidhur të cilës, është leja e lëshuar nga Bashkia Tiranë, në të cilën, shfaqet gjurma e pronës truall të investitorit, e cila përfshinë edhe sipërfaqe të cilat IPS e Asgjësisë Kombëtare të Kadastrës, i klasifikon në regjistrimin e datës 25.07.2014, pronë e Ndërmarrje së Trajtimit të Studentëve nr. 2 SHA (sot RSU nr. 2 SHA). Aneks Kontrata është në

mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, neni 9/1/2/c dhe nenin nr. 54/e. Përmes këtij aneks kontrate, RSU nr. 2 SHA ka miratuar që investitori të jetë posedues i pronave të RSU nr. 2 SHA, në mospërputhje me ligjin nr. 44/2015, neni 97/1 dhe nenet 104/1, 104/2 dhe 104/4/a.

4.1. Rekomandimi: Këshilli Bashkiak Tiranë në cilësinë e Asamblesë së Aksionarëve të RSU nr. 2 mbi pronat, të analizojë situatën e krijuar në lidhje me këtë pronë, të nxjerrë përgjegjësitë për lidhjen e marrëveshjeve dhe të marrë masa për ndjekjen administrative dhe ligjore për tejkalimin e kompetencave nga Administratorët dhe Këshilli Mbikëqyrës, me qëllim eliminimin e pasojave të këtyre akteve në të ardhmen.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin, miratimin e strukturës organizative, rekrutimin dhe largimin e punonjësve konstatohet se, RSU Nr. 2, SHA Tiranë, nuk ka procedurë të miratuara për kriteret e rekrutimit të punonjësve me përcaktime sipas formimit profesional, eksperiencës në punë kualifikimeve ekuivalente. Fakt i cili nuk e bën transparente procedurën. Struktura e shoqërisë vazhdon të jetë e mbingarkuar edhe pse gjatë auditimeve të më përparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit është lënë vazhdimisht si rekomandim përshtatja e strukturës së shoqërisë me nevojat reale të saj. Aktualisht është e përbërë prej 180 punonjësish. Në strukturën e shoqërisë rezulton se ka punësime të pa nevojshme dhe që dublojnë njëra tjetrën siç është pozicioni i recepsionistit me specialisten e zyrës së informacionit etj., pozicioni i dushisteve, pozicioni i specialistes dita ujë, pozicioni i protokoll-arkivës me 4 punonjëse, 2 magazinierë etj., pozicione të cilat kanë detyra të përbashkëta ndërmjet tyre. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë miratuar me vendimin nr. 81 , datë 27.06.2018 të KM.

5.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, Tiranë, duhet miratojë një strukturë të re ku të vendosë kritere specifike, të mirë përcaktuara dhe procedura punësimi të qarta sipas formimit profesional, eksperiencës në punë kualifikimeve ekuivalente me qëllim zhvillimin e një procesi sa më transparent, të përshtatur me nevojat reale të saj.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje automjeti për shoqërinë” për vitin 2017, me vlerë kontrate 1,245,000 lekë pa TVSh, referuar zbatimit të kontratës dhe verifikimit mbi marrjen në dorëzim të automjetit rezulton se; me shkresën nr. 270/11 prot., datë 17.10.2017 është hartuar akti i kolaudimit nga komisioni i marrjes në dorëzim të automjetit, në të cilin pasi, sipas tyre është kryer kontrolli fizik, shprehen se, automjeti plotëson specifikimet teknike sipas kërkesave të AK, ndër të cilat konsumi mesatar është jo më shumë se 5,5 litra/100 km. Në aktin e kolaudimit citohet se gomat janë me rreze R16 dhe masa e mjetit bosh është 1,600 kg, ndërkohë që referuar librezës së automjetit gomat janë R17 dhe masa e mjetit bosh është 1,640 kg. Pra komisioni nuk ka marrë në përputhje me specifikimet teknike automjetin e kërkuar. Pësia e automjetit dhe rezja e gomës jo sipas specifikimeve mund të ndikojnë në një konsum më të lartë të karburantit. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pika 42-47.

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i RSU nr. 2 SHA, të marrin masa që, anëtarët e komisioneve të krijuara të marrin në dorëzim mallrat sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe specifikimet teknike të vendosura me qëllim eliminimin e formaliteteve të marrjes në dorëzim të mallrave.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se, në 4 procedura prokurimi sasia e kërkuar për kontrata mallra, nuk është bërë nga lidhja e kontratës dhe deri në fund të vitit në të cilin është kryer procedura, sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit por është vazhduar dhe llogaritur edhe në vitin pasardhës, ndërkohë që sipas RrPP, duhet që llogaritja dhe kërkesa të bëhet deri në fund të vitit financiar, konkretisht në procedurat si; *“Blerje solar”, viti 2018, me vlerë kontrate 2,500,000 lekë pa TVSh, “Blerje solar”, viti 2017, me vlerë kontrate 4,166,666 lekë pa TVSh, “Blerje karburanti” viti 2018, me vlerë kontrate 1,075,825 lekë pa TVSh, “Blerje solar”, viti 2019 me vlerë kontrate 3,500,000 lekë.* Referuar kërkesave të bëra rezultoi se sasia e kërkuar nuk është llogaritur nga lidhja e kontratës me afat deri në përfundim të vitit, sipas DST-ve. Pra sasia e kërkuar është më tepër se sa është nevojë e AK deri në fund të vitit. Veprime në mospërputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar neni 76. Për 5 raste, janë lidhur kontratat me OE, pa patur mjetet financiare në dispozicion. Kjo pasi likuidimet janë kryer nga 2 deri në rreth 10 muaj me vonesë nga pranimi i faturës dhe marrja në dorëzim e mallit. Konkretisht në procedurat e prokurimit si; *“Blerje materiale hotelerie”, viti 2017, “Blerje karburanti”, viti 2018, “Blerje detergjente dhe materiale për pastrim”, viti 2018, “Blerje detergjente dhe materiale për pastrim”, viti 2019, “Blerje solar”, viti 2019.* Këto veprime mund të sjellin premisa për kërkim të penalteteve si rezultat i likuidimeve të vonuara, nga OE, referuar kushteve të kontratës, gjë e cila nuk ka ndodhur në procedurat e audituara. Veprime këto në mospërputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 70.

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i RSU nr. 2 SHA, Drejtori Ekonomik, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat e duhura që, përpara lidhjes së kontratave publike, të sigurohen për fondet në dispozicion të vlerës së tyre.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditivi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt *“Shërbim Privat për ruajtjen dhe sigurinë fizike të objekteve të Shoqërisë për vitin 2018”*, me fond limit në shumën 4,268,705 lekë pa TVSh, rezultoi se në llogaritjen e fondit limit, orari i kërkuar për shërbimin e ruajtjes së sigurisë fizike me roje private në specifikimet teknike është vendosur për itinerarin 23:00-07:00 ndërkohë që është llogaritur shtesa mbi pagën për 8 orë me 50 %. Sipas Kodit të punës itinerari për të cilin punonjësi përfiton rritje prej 50 % të pagës është nga ora 22:00-06:00. Ndërkohë që llogaritja sipas rekomandimit të APP dhe KPP, duhet të ishte për 7 orë përfitimi për shtesën mbi pagë me 50% dhe jo për 8 orë sa është llogaritur nga komisioni përkatës. Nga rillogaritja e grupit të auditimit rezultoi e vlera e fondit limit duhej të ishte 4,110,595 lekë pa TVSh. Operatori ekonomik fitues ka ofertuar me vlerë oferte 4,065,441 lekë pa TVSh. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në procedurën e prokurimit me objekt *“Shërbim Privat për ruajtjen dhe sigurinë fizike të objekteve të Shoqërisë për vitin 2019”*, me fond limit në shumën 8,741,391 lekë pa TVSh. Nga rillogaritja e grupit të auditimit rezultoi e vlera e fondit limit duhej të ishte 8,417,601 lekë pa TVSh. Pra diferenca prej 8,741,392.48-8,417,601= 323,791 lekë pa TVSH është rritje e fondit limit. Operatori ekonomik fitues ka ofertuar me vlerë oferte 8,016,761 lekë pa TVSh. Veprime në mospërputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar neni 59, pika 2 dhe nuk i përmbahet rekomandimit të përbashkët të APP me nr. 15166, dhe KPP me nr. 1858, datë 20.12.2017.

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë RSU nr. 2, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masa që, në procedurat e prokurimit të Ruajtjes së Sigurisë fizike, llogaritja e fondit limit të bëhet sipas itinerarit të përcaktuar në specifikimet teknike.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës “*Blerje Solar për vitin 2018*” rezulton se vendosja e kriterit “*Operatori ekonomik të paraqesë Raport Analizë për mallin objekt prokurimi në përputhje me standardin Shqiptarë SSH 6579:2010 lëshuar nga inspektorati shtetërorë teknik industrial, jo më parë se 1 muaj nga data e hapjes se ofertave e cila është me datë 19.11.2018*”, ka sjellë si pasojë s’kualifikimin e OE me vlerë oferte më të ulët. Konkretisht OE “T...”, me vlerë oferte ekonomike me marzh fitimi 12.18 % e cila ka një diferencë me OE e kualifikuar si fitues “R... E...” me marzh fitimi 33%, në shumën 469,363 lekë. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, nenin 46, pika 3, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28, neni 61 pika 2 dhe neni 27, pika 3. Njësia për këtë kriter nuk ka argumentuar pse duhet që flet analiza të jete e një muaji më parë, ndërkohë OE i është kërkuar që të plotësohet deklaratë e përmbushjes së specifikimeve teknike në bazë të së cilës ata mbajnë përgjegjësi nëse nuk e sjellin mallin në përputhje me specifikimet e kërkuara. Për sa më sipër, vendosja e këtij kriteri pa argumentuar ndikon në pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik pasi mund të ketë operatorë të cilët nuk kanë furnizim të muajit të fundit por mund të kenë gjendje mallin e kërkuar dhe mund të ofrojnë marzh fitimi më të ulët nga të tjerët. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje zbatimin e kontratave të procedurave të prokurimit me objekt “*Blerje solari*” për të tre vitet 2017-2019, rezultoi se nga komisioni i mbikëqyrjes së kontratave nuk është hartuar një raport përmbledhës për realizimin e kontratës në kundërshtim me nenin 77 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për procedurat e prokurimit. Veprim për të cilin mbajnë përgjegjësi dhe anëtarët e komisionit të mbikëqyrjes së kontratës.

9.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i RSU nr. 2 SHA të marrë masa për trajnimin e stafit, në lidhje me hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik, gjithashtu nga Përgjegjësi i Prokurimeve të merren masat që, hartimi i kriterëve dhe DST-ve, të bëhet në përputhje me kuadrin rregullator të LPP me qëllim, shmangien e vendosjes së kriterëve jo të lidhura ngushtë me objektin që prokurohet.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës së furnizimi me objekt “*Blerje solar për ngrohje vitin 2019*”, konstatohet se në bazë të nenit 9 të kontratës, furnizimi do të bëhet duke filluar nga lidhja e kontratës në mënyre periodike deri në 31.12.2019 sipas kërkesave të AK. Nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk ka asnjë shkresë/kërkesë për furnizim me solar drejtuar kontraktorit. Për vitin 2019 janë vetëm dy memo të përgjegjësit të sektorit të kaldajave B. H., drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtorit ekonomik me objekt kërkesë për furnizim me lëndë djegëse solar konkretisht me anë të shkresave nr. 381 datë 18.06.2019 është kërkuar solar për furnizimin e godina nr. 1 dhe 2 mjekësi por, pa sqaruar sasinë dhe ditën dhe shkresa nr. 333 datë 05.06.2019 është kërkuar solar për kaldajën e godinave 3 dhe 4 tek mjekësia edhe këtu pa sqaruar sasinë dhe datën kur duhet të bëhet furnizimi me solar. Në këto kushte nuk evidentohet nëse operatori i ka përmbushur detyrimet të cilat i rrjedhin nga kontrata sipas kërkesave dhe kushteve të autoritetit Kontraktor. Nga verifikimi i faturave dhe urdhërshpenzimeve rezulton se deri në fund të vitit 2019 për kontratën e furnizimit me solar për vitin

2019 nga ky subjekt është sjellë e gjithë sasia e solarit të prokuruar në vlerën 4,200,000 lekë. Por, nga ana e AK nuk janë likuiduar tre faturat e fundit të furnizimit edhe pse kanë kaluar rreth 4 muaj nga furnizimi i mallit, kjo për arsye se aktualisht shoqëria nuk ka fonde në dispozicion për vitin 2019. Veprime këto në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 70, pasi, rezultoi se kontrata e furnizimit me solar është lidhur pa pasur fondet në dispozicion. Kjo vjen si pasojë edhe e një bashkëpunimi ndërmjet drejtorisë ekonomike dhe Titullarit të RSUN. 2 për të ditur gjendjen e mjeteve financiare në dispozicion në momentin e lidhjes së kontratës. Veprim për të cilin mban përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor, Zh. D. dhe E. C. në cilësinë e nëpunësit zbatues.

10.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i RSU nr. 2 SHA, Drejtori Ekonomik, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat e duhura që, përpara lidhjes së kontratave publike, të sigurohen për fondet në dispozicion të vlerës së tyre.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Administratori i Shoqërisë RSU nr. 2 SHA (më herët NTS nr. 2 SHA) ka marrë vendime për emërim dhe lidhje kontrate me Drejtuesin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe Specialistin e NJAB, miratim të planeve Audituese, Miratim të raporteve audituese, zgjatje të periudhës së daljes në pension të Drejtuesit të NJAB, komandim në detyrë të Drejtuesit të NJAB, rekrutim të specialistëve të NJAB, në mospërputhje me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, nenet 4 pika 18, 10 pika 2 dhe 11, në të cilin kërkohet që emërimi, varësia dhe raportimi i NJAB të jetë nga titullari i shoqërisë pra nga Asambleja e Përgjithshme. Shoqëria përmes Administratorit ka zgjidhur njëanshmërisht, kontratën e punës me Specialistin e NJAB dhe nuk ka marrë në konsideratë ankimmimet tek Administratori, KM, dhe AP e shoqërisë. Shoqëria ka angazhuar NJAB në detyra të tjera përveç atyre audituese, si caktim në Njësinë e Sinjalizimit, dhe në hartimin e Statutit të Shoqërisë. Gjithashtu i është kërkuar të hartojë Regjistrin e Riskut dhe t’jua paraqes për miratim Nëpunësit Autorizues. Gjithë sa më sipër janë në mospërputhje me ligjin nr. 114/2015, nenet 4, 5, 6, 10 dhe 11. Është marrë vendim për strukturën e shoqërisë ku është planifikuar vartësia e NJAB nën Administratorin (Drejtor i Përgjithshëm).

Administratorët kanë marrë vendime për auditim nga NJAB të Bashkisë Tiranë, ndërkohë që kanë një NJAB në strukturë, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016, pika 4. Nga Administrimi i Shoqërisë rezulton se nuk ka asnjë shkresë në periudhën audituese për caktimin e Nëpunësit Zbatues, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9/4. Emërimi i Drejtuesve të NJAB, është bërë pa patur Certifikatë të Audituesit të Pavarur nga data 01.07.2017 deri në datën 31.09.2019 dhe nga data 01.10.2019 deri në datën 31.12.2019 pa eksperiencë mbi 5 vjet në NJAB. Emërimi në detyrë i NJAB nuk është kryer nga AP e Aksionarëve, por nga administratori, në mospërputhje me Ligjin nr. 114/2015, neni 12. Miratimi i planeve të auditimit, Raporteve të auditimit, Regjistrin të riskut të NJAB, Karta e Auditimit, Kodi Etik i NJAB nuk është bërë nga AP, por nga Administratori dhe me miratimin e KM në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni 4/7, 4/12, 4/13 dhe 4/18. NJAB nuk ka raportuar në AP të Shoqërisë, në mospërputhje me Ligjin nr. 119/2015, neni 14/d. Përcaktimi Strukturës së NJAB dhe pagave dhe kërkesave për NJAB nuk është bërë në përputhje me VKM nr. 187, datë 08.03.2017.

11.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues të marrë masa për caktimin e Nëpunësit Zbatues dhe njoftimin e Nëpunësit të Parë Autorizues për këtë vendim.

11.2. Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme (AP) në cilësinë e Titullarit të marrë për emërimin e Drejtuesit të NJAB, si dhe për plotësimin e NJAB me tre auditues. Gjithashtu të marrë masa për

miratimin e Kartës së NJAB dhe të Kodit të Etikës së NJAB, për miratimin e Planeve të NJAB, Raporteve të NJAB, dhe Regjistrin e Riskut të Shoqërisë. Nga NJAB të merren masa për raportim të vazhdueshëm në Asamblenë e Përgjithshme.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: RSU nr. 2, SHA Tiranë në periudhën audituese nga data 01.07.2017 deri në fund të kësaj periudhe 31.12.2019 ka probleme me mjedisin e kontrollit sepse titullari Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve: Nuk ka krijuar kushtet për ngritjen dhe zhvillimin e NJAB sipas ligjit për auditin e brendshëm dhe MFK-së, neni 20/1, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010; Nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik në mospërputhje me MFK, neni 8/8/b; Nuk ka rregulluar mënyrën e menaxhimit të informacionit në shoqëri, në mospërputhje me MFK, neni 8/8/c; Shoqëria nuk ka objektiva të planifikuara, të matshme dhe të arritshme, nuk ka një rregullore të përditësuar. Administratori ka bërë ndryshime të veçanta në rregulloren e drejtorive të vartësisë që nuk janë implementuar në rregulloren e shoqërisë, dhe nuk janë miratuar në KM të shoqërisë. Nuk ka një strategji risku të miratuar nga Titullari në mospërputhje me MFK, neni 21/2; Nuk ka caktuar koordinatorin e riskut. Kjo detyrë i takon Nëpunësit Autorizues, por në mospërputhje me MFK, neni 10/2/c; Nuk ka një procedurë të identifikimit, vlerësimit dhe përcaktimit të riskut; Nuk ka përgatitur “Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm”, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 28, datë 25.12.2011, Kapitulli I; Nuk ka përgatitur Raporti vjetor i gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 28, datë 25.12.2011, Kapitulli II; Nuk ka dorëzuar “Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2017, 2018 dhe 2019” në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në mospërputhje me MFK, neni 18/1; Ka krijuar njësinë anti-korrupsion në mospërputhje me ligjin nr. 114/2015, neni 17/a, sipërcituar; Nëpunësi Zbatues në hartimin e regjistrin të riskut ka përfshirë edhe NJAB të paraqes nivelin e riskut për këtë njësi, ndërkohë që kjo njësi auditon mbi këtë regjistër. Nuk ka një gjurmë auditimi për proceset bazë të shoqërisë, në evidentimin e troje dhe ndërtesa, në njësi matëse dhe vlerë, në mospërputhje me MFK, neni 12/3/f; Nuk ka një hartë procesesh për ndjekjen e dokumentacionit dhe afatet e përgjigjeve, ndaj dokumenteve të deleguara, në mospërputhje me MFK, neni 9/4/ë; Nuk ka masa të shkruara për të pakësuar nivelin e riskut për punonjësit me natyrë delikate, si prokurimet, ndjekja e kontratave, ruajtja e aktiveve afatgjata së bashku me inventarizimin e tyre, në mospërputhje me MFK, neni 9/4/ë; Nuk ka një procedurë të shkruar mbi rrjedhën dokumentare në RSU Nr. 2 SHA, Tiranë, në mospërputhje me MFK, neni 9/4/d.

12.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa për dizenjimin dhe implementimin e kërkesave për sisteme kontrolli të brendshëm efektiv. Nëpunësi Zbatues të marrë masa për krijimin e plotë të gjurmës së auditit për çdo proces, por në veçanti dhe pa u kufizuar në to, për troje dhe ndërtesa duke i shprehur në njësi matëse dhe vlerë, krahas historikut të tyre Gjithashtu të rritet trajtimi i stafit me kërkesat e ligjit të MFK.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve materiale me vlerë fillestare 6,507,034 lekë, vlerë të mbetur 814,838 lekë të RSU nr. 2, konstatohet që: Shoqëria në vitin 2018 ka kryer procesin e asgjësimit të disa aktiveve të nxjerra nga procesi i inventarizimit, të vlerësuara si jashtë përdorimit. Në përbërje të listës së aktiveve të cilat janë asgjësuar rezultojnë se, *ka materiale elektrike dhe elektronike të cilat konsiderohen të dëmshme dhe nuk duhet të hidheshin apo të*

asgjësoheshin, pa një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga këto pajisje të destinuara për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga Titullari i RSU nuk ka asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe gruposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Në lidhje me pajisje nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e asgjësimit të tyre, nuk ka asnjë vlerësim për ndikimin që kanë gruposja e tyre në mjedis. Veprime në mospërputhje me Ligji nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, neni 45, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”.

31.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë RSU nr. 2, Drejtorja Ekonomike, të marrin masa në të ardhmen që, në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet parasysh kuadri rregullator ligjor me qëllim shmangien e hedhjeve të materialeve të dëmshme dhe mbrojtjen e mjedisit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se: Në të gjitha rastet e verifikuara rezultoi se nuk është verifikuar, dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë. Në të gjitha rastet e audituara procesverbalet e mbajtura nga komisioni i prokurimit, për procedurat blerje me vlera të vogla, të kryera me mjete elektronike, në lidhje me vijueshmërinë e kalimit nga operatori i renditur në vendin e parë dhe deri në përcaktimit të ofertës fituese, si dhe procesverbalet e mbajtura në procedurat e prokurimit për rastet emergjente, përcjelljet e praktikave për pagesë tek sektori i financës, nuk janë të protokolluara. Në 1 (një) rast në vitin 2018 shpenzimi është kryer duke mos e justifikuar nevojën e kryerjes së tij. Në 2 (dy) raste në vitin 2018 rezultoi se nuk ka urdhër nga titullari për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimeve. Në 1 (një) rast në vitin 2018 Operatori ekonomik i ofertuar nuk ka në fushën e veprimtarisë së tij, objektin e prokurimit. Në 1 (një) rast nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi. Në 8 (shtatë) raste në vitin 2018 dhe në 5 raste në vitin 2019 konstatohet se, faturat tatimore nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla. Veprime në mospërputhje me nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenin 2, 3 e 8/1, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 3, nenin 57, pika 2 dhe 3, neni 77, pika 3, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 7, 19.

13.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë RSU nr. 2, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masa që, për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara sa më sipër, gjithashtu të veprohet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Menjëherë

B. I. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve me bankë rezultoi se për zbatimin e kontratës me nr. 46/7, datë 25.04.2016 është krijuar me urdhrin nr. 208, datë 29.06.2017, nga titullari i RSU V. B. komisioni i marrjes në dorëzim të lëndës djegëse me përbërje I. F., I. M., E. Gj., P. Sh. e I. A. Janë likuiduar 3 urdhër-xhirime për 3 furnizime të ndryshme, ndaj operatorit “T... SHA” në shumën totale 3,159,537 lekë për sasinë prej 26,333 litra. Referuar të dhënave të dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se sasia e furnizuar është në parametrat e naftës bruto dhe jo të lëndës djegëse D1 mbi të cilin janë kryer llogaritjet e vlerës së secilës faturë. Për këtë arsye çmimi i marrë në buletinin e APP, për secilën prej furnizimeve të mësipërme i llogaritur nga OE dhe i pranuar nga Shoqëria RSU, i referohet çmimit të lëndës djegëse me përmbajtje squfuri më tepër se 1% ndaj peshës, ndërkohë që sipas densitetit të paraqitur, përmbajtjes së ujit sipas fletë analizës dhe përmbajtjes së squfurit, janë tregues të naftës së pa përpunuar, pra naftës bruto. Pra çmimi mbi të cilin duhet të bëhej llogaritja e vlerës së faturës për mallin e sjellë nga OE duhet të llogaritej me çmimin e naftës bruto. Nga nëpunësi zbatues nuk janë kryer verifikimet e duhura sipas legjislacionit përpara se të kryhej pagesa ndaj OE, për të dhënat e paraqitura. Referuar faktit se llogaritja e vlerës së faturës për të 3 likuidimet e kryera nuk është bazuar në çmimin e produktit që i është ofruar sipas të dhënave të paraqitura nga OE “T... SHA”. Çmimi i përlllogaritur nga grupi i auditimit është; Për sasinë 13,824 litra çmimi i OE është 112.46 lekë/litër ndërkohë që duhet të ishte 72.06 lekë/litër pra me një diferencë 40.4 lekë/litër në shumën 558,495 lekë më tepër. Për sasinë 6,305 litra çmimi i OE është 116.19 lekë/litër ndërkohë që duhet të ishte 73.58 lekë/litër pra me një diferencë 42.61 lekë/litër në shumën 268,645 lekë më tepër. Për sasinë 6,204 litra çmimi i OE është 119.66 lekë/litër ndërkohë që duhet të ishte 74.74 lekë/litër pra me një diferencë 44.93 lekë/litër në shumën 278,701 lekë më tepër. Nga Shoqëria nuk janë kryer verifikimet dhe llogaritjet e duhura dhe shuma totale prej 1,105,840 lekë është përfituar më tepër nga OE i kontraktuar, veprim në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pikat 9 dhe 18, neni 9 dhe 12, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 42, 43, 45. Shuma prej 1,105,840 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë, si përfitim i padrejtë nga OE.

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë RSU nr. 2, Drejtorja Ekonomike, të marrin masa që, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës 1,105,840 lekë, nga Operatori Ekonomik “T... SHA”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se:

Në dy raste konstatohet se për procedurat e prokurimit “Për shërbimin Deratizim, Dezinfektim dhe Dezinspektim”, për vitin 2017 është likuiduar OE “A... P...” i shpallur fitues për punë të pa kryera në shumën 34,465 lekë me TVSh, dhe për vitin 2018 në këtë procedurë është shpallur fitues OE “F... L...”, i cili është likuiduar për punë të pakryer në shumën 71,905 lekë me TVSh. Konstatohet se në momentin e pranimit të faturës tatimore dhe kryerjes së likuidimit, nga Drejtorja Ekonomike nuk janë verifikuar aktet e marrjes në dorëzim të komisionit të mbikëqyrjes së kontratës për shërbimin e kryer pasi, sipas akteve në momentin e likuidimit shërbimet nuk janë për të gjithë sipërfaqen të cilën duhet të mbulonte OE. Veprime në mospërputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në

njësitë e sektorit publik", pikat 35 dhe 36. Shuma totale prej 88,641 lekë pa TVSh dhe 106,370 lekë me TVSh konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë si përfitim i padrejtë nga OE.

2.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë RSU 2, Drejtoria Ekonomike, të marrin masa që, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës 28,720 lekë, nga OE A.... P.... dhe arkëtimin e shumës 59,920 lekë nga OE F....L....

Menjëherë

B.II. MASA PËR ELIMINIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e aktiveve të Shoqërisë RSU nr. 2, SHA rezultoi se; në godinat e Inxhinierisë A, B, C dhe D të akomodimit të studentëve është bërë investim në shumën 5,200,839 euro ose referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.2019 në shumën **633,306,165 lekë**. Investimi është kryer në kuadër të projektit “Për rehabilitimin e konvikteve” (Grant) financiar nga KfW, në të cilin kanë filluar punimet në 25.04.2017 për godinat A e B dhe për godinat C e D kanë filluar në 20.06.2018. Në vitin 2018 në godinat A e B kanë përfunduar punimet dhe janë kryer dhe regjistrimet e para të studentëve të cilët janë akomoduar në këto godina. Në lidhje me dorëzimin e aktiveve dhe përfundimin e punimeve të rikonstruksionit të godinave konstatohet se deri në fund të procesit të auditimit në subjekt si, dokumentohet dorëzimi i aktiveve të cilat administrohen dhe ruhen nga RSU, për të cilat kanë sjellë ndryshime në vlerën e pasurisë si rezultat i investimit të kryer, nuk ka asnjë dokumentacion në lidhje me marrjen në dorëzim të punimeve në aktivet e shoqërisë; Nuk ka asnjë njohje të kësaj vlere të aktivitetit të vënë në përdorim dhe as të marrëveshjes së financimit në pasqyrat financiare, të cilat duhet të evidentohen në kohën e njohjes dhe nënshkrimit të tyre, në llogarinë “Grante”, me justifikimin se Drejtuesit e RSU nuk kanë qenë në dijeni të këtij investimi, pavarësisht se përdorin godinat e ristrukturuara. Godinat kanë përfunduar dhe janë vënë në efikasitet nga shoqëria duke akomoduar studentët që në vitin 2018, dhe ende nuk ka asnjë dokumentacion për marrjen në dorëzim të punimeve nga RSU dhe as evidentimin në pasqyrat financiare të kësaj vlere me impakt, në PF të Shoqërisë. Pra për këtë investim RSU nr. 2, është vetëm përfituesi fundor pasi me procedurat e tjera që prej marrëveshjes financiare deri në ndjekjen, implementimin dhe përfundimin e projektit, janë përgjegjëse MF dhe MIE por, nga shoqëria nuk janë marrë masat përkatëse që vlera e investimit (Grantit) të kalojë në llogaritë përkatëse dhe të bëhet pasqyrimin e saktë në PF. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 16, 17, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit 10 “Grantet dhe forma të tjera të ndihmës”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 34 e 36.

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Shoqërisë RSU nr. 2, të marrë masa të menjëhershme për saktësimin e vlerës së aktivitetit për shumën e investimit të përfituar përmes Grantit në Pasqyrat Financiare. Të llogaritet amortizimi i investimit dhe paraqitja e saktë e vlerës së amortizimit të grantit të përfituar.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla rezultoi se, në 7 raste në vitin 2018 në shumën totale **1,909,200**

lekë dhe në 9 raste në vitin 2019 në shumën totale **2,046,640 lekë**, u konstatuan pagesa të cilat janë paguar duke kaluar afatin prej 30 ditësh nga marrja e faturës tatimore, çka do të thotë se në momentin e lidhjes së kontratës, për punë mallra apo shërbime Autoriteti Kontraktor nuk ka patur mjetet e mjaftueshme financiare. Pra konstatohet se janë ndërmarrë angazhime pa patur fonde në dispozicion referuar dhe situatës dhe rezultateve financiare negative të konstatuara në fund të viteve 2018-2019. Këto veprime janë kryer në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 70.

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë RSU nr. 2, Drejtoria Ekonomike, të marrin masa që, për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla lidhja e kontratave, të kryhen vetëm pasi të jenë siguruar dhe të disponohen në llogarinë e Shoqërisë, mjetet e nevojshme financiare, për të shmangur penalitetet e mundshme nëpërmjet kamatëvonesave. Gjithashtu në mënyrë të menjëhershme të ndërpriten praktikat ku procedurat e prokurimit realizohen në mungesë të fondeve në dispozicion.

Menjëherë

***Shënim:** Masat të cilat do të rekomandohen Portit Detar SHA Shëngjin do të bëhen pjesë plotësuese e këtij vendimi në përfundim të marrjes dhe trajtimit të observacioneve mbi Projektraportin e përcjellë në këtë subjekt.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

K R Y E T A R

Arben SHEHU